

VLERËSIMI I SITUATËS DHE POTENCIALEVE

të bimëve mjekësore & aromatike, në zonën e Korab-Koritnik.



DHJETOR 2022

Ky raport është publikuar nga organizata World Vision Albania në kuadër të projektit "Përmirësimi i jetesës përmes ruajtjes së biodiversitetit të parkut natyror Korab-Koritnik", financuar nga Prespa Ohrid Nature Trust – PONT.

Raporti është hartuar nga:

- Prof. Dr. Alban Ibraliu
- Dr. Zyber Gjoni

Grupi teknik mbështetës:

Majlinda Hoxha, Këshilltare Teknike, World Vision Albania
Erblin Burnazi, Manaxher Projekti, World Vision Albania

Raporti mund të përdoret lirisht nga grupet e interesit. Në çdo rast, shumëfishimi ose ripublikimi i këtij raporti duhet të shoqërohet me autorizimin e World Vision Albania dhe PONT.


PËRMBAJTJA

Vlerësimi i situatës dhe potencialeve të bimëve mjekësore dhe aromatike, në zonën e Korab-Koritnik.....	1
1. HYRJE	4
1.1 EROZIONI GJENETIK	5
1.2 SISTEMI I ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE (SZMM) NË SHQIPËRI	6
2. VLERËSIMI I BIODIVERSITETIT TË BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE (BAM) NË ZONËN E MBROJTUR KORAB-KORITNIK (KKPA)	9
2.1 REZERVATI NATYROR I MENAXHUAR/PARKU NATYROR KORAB – KORITNIK	9
2.2 RESURSET GJENETIKE TË BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE NË REZERVATIN NATYROR TË MENAXHUAR KORAB-KORITNIK	14
3.VLERËSIMI I POTENCIALIT PRODHUES TË BMA-VE NË KKPA DHE SITUATA E KULTIVIMIT TE TYRE	28
3.1 PËRVOJA E VENDIT TONË NË GRUMBULLIMIN DHE PËRDORIMIN E BIMËVE AROMATIKE E MJEKËSORE DHE GJENDJA E TYRE PARA VITEVE '90	28
3.2 VJELJA DHE GRUMBULLIMI I BMA-VE TË ZONËS KORAB KORITNIK PARA VITEVE '90	29
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR VJELËSIT PRANË ZONËS KORAB-KORITNIK.....	33
3.4 BIMËT E FLORËS SPONTANE QË MBLIDHEN NË ZONËN E MBROJTUR KORAB – KORITNIK.....	37
a. Njësia administrative Muhurr	37
b. Njësia Administrative Melan	38
c. Njësia administrative Maqellarë	39
d. Njësia administrative Kastriot	40
e. Njësia administrative Sllovë	41
3.5 SASIA E BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE TË VJELA NGA FLORA SPONTANË PARKUN KOMBËTAR KORAB – KORITNIK	42
3.6 BIMËT AROMATIKE DHE MJEKËSORE TË KULTIVUARA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE PARKUT KOMBËTAR KORAB – KORITNIK	42
3.7 TË ARDHURAT NGA BIMËT AROMATIKE DHE MJEKËSORE	43
3.8 BASHKËPUNIMI MIDIS VJELËSVE DHE GRUMBULLUESVE, LOGJISTIKA	45
3.9 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR GRUMBULLËSIT DHE PËRPUNUESIT E BMA-VE	45
Sasitë e BMA_ve të deklaruara nga grumbulluesit dhe përpunuesit e intervistuar	46
3.10 TRAJNIMI ME VJELËSIT E ZONËS SË MBROJTUR KORAB KORITNIK	49
4.PERFUNDIMET/KONKLuzionET	51
5. REFERENCAT	53
6. ANEKSET	54

1. Hyrje

Shqipëria, karakterizohet nga një klimë e larmishme pavarësisht sipërfaqes së vogël të territorit prej 28,748 km². Falë larmisë së madhe të formave të relievit, të klimës me ndryshime të theksuara në një territor krahasimisht të vogël, Shqipëria zotëron një bimësi të shumëllojtë duke e bërë atë një nga vendet ballkanike dhe evropiane me pasuri bimore të veçantë.

Fakti që nga rreth 11,000 lloje bimësh që gjenden në Evropë, rreth 3,250 lloje (30 %) rriten në Shqipëri, nga të cilat 157 janë lloje dhe nënlloje endemike, me një dendësi prej 113 lloje për 1,000 km² është mjaft domethënëse. Në bimësinë e Shqipërisë 15% janë lloje ballkanike, 6 % lloje subendemike, 4 % interspecifike dhe 1 % endemike (30 specie).



Grafiku 1: Klasifikimi i bimësisë në Shqipëri

Vendi ynë karakterizohet gjithashtu edhe nga një larmi e madhe e bimëve etero-vajore dhe mjekësore. Në vendin tonë rriten më shumë se 700 lloje bimësh mjekësore, të cilat përfaqësojnë rreth 20% të gjithë florës së vendit. Rreth 350 prej tyre grumbullohen, përpunohen dhe shiten.

Bimët mjekësore dhe etero-vajore konsiderohen si një nga potencialet kryesore të ripërtëritshme për zhvillimin social-ekonomik të vendit në tërësi dhe të zonave rurale në veçanti.

Ndër bimët aromatiko-mjekësore, që kanë patur dhe kanë një peshë të madhe në prodhimin kombëtar konsiderohen: sherbela (*Salvia officinalis* L.), rigoni i bardhë (*Origanum vulgare* L.), trumza (*Satureja montana* L., dëllinja e zeze (*Juniperus communis* L.), lulebasani (*Hypericum perforatum* L.), molla e eger (*Malus sylvestris* L.), tredafili i eger (*Rosa canina* L.) dhe lulemurri (*Crataegus monogyna* L.).

1.1 Erozioni gjenetik

Gjatë 30 viteve të fundit, në shumë zona, për të përfituar maksimalisht, është bërë një shfrytëzim jashtë normave dhe kriterëve të përcaktuara për grumbullimin e bimëve mjekësore dhe si pasojë, shumë prej kësaj pasurie natyrore është zvogëluar në numër dhe në sipërfaqe. Nëse, në vitet e ardhshme vazhdohet me këto ritme, disa bimë mjekësore do të shkojnë drejt pakësimit e më vonë drejt zhdukjes.

Faktorë të tjerë që kanë shkaktuar një erozion gjenetik të bimëve aromatike mjekësore konsiderohen dhe zjarret, shtrirja e bujqësisë, shpyllëzimet, prerjet pa kriter dhe erozioni i tokës.

Sipas studimeve dhe të dhënave të grumbulluara në terren në Shqipëri rezulton se në grupin e bimëve mjekësore e aromatike:

1. 3 specie janë të rralla (R).
2. 5 specie janë të prekshme (V).
3. 3 specie janë të kërcënuara me zhdukje (Ex).
4. 29 specie janë të rrezikuara. (E).

Në vijim paraqitet lista e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike (BMA) me statusin e rrezikuar të përfshira në Librin e Kuq të Florës së Shqipërisë.

1. <i>Aesculus hippocastanum</i> L.	21. <i>Orchis coriophora</i> L.
2. <i>Allium ursinum</i> L.	22. <i>Orchis laxiflora</i> Lam.
3. <i>Anacamptis pyramidalis</i> (L.) Rich.	23. <i>Orchis mascula</i> L.
4. <i>Arctostaphylos uva-ursi</i> (L.) Spreng.	24. <i>Orchis militaris</i> L.
5. <i>Atropa bella-donna</i> L.	25. <i>Orchis morio</i> L.
6. <i>Colchicum autumnale</i> L.	26. <i>Orchis pallens</i> L.
7. <i>Convallaria majalis</i> L.	27. <i>Orchis papilionacea</i> L.
8. <i>Dictamnus albus</i> L.	28. <i>Orchis provincialis</i> Balbis.
9. <i>Dryas octopetala</i> L.	29. <i>Orchis purpurea</i> Hudson.
10. <i>Ephedra distachya</i> L.	30. <i>Orchis simia</i> Lam.
11. <i>Eryngium maritimum</i> L.	31. <i>Orchis tridentata</i> Scop.
12. <i>Galanthus nivalis</i> L.	32. <i>Osmunda regalis</i> L.
13. <i>Gentiana lutea</i> L.	33. <i>Paeonia peregrina</i> Mill.
14. <i>Glaucium flavum</i> Crantz.	34. <i>Phyllitis scolopendrium</i> (L.) Neëm.
15. <i>Hypericum androsaemum</i> L.	35. <i>Rhus coriaria</i> L.
16. <i>Ilex aquifolium</i> L.	36. <i>Ruta graveolens</i> L.

17. <i>Juniperus oxycedrus</i> L.	37. <i>Salvia officinalis</i> L.
18. <i>Juniperus communis</i> L.	38. <i>Sideritis raeseri</i> Boiss & Heldr
19. <i>Menyanthes trifoliata</i> L.	39. <i>Taxus baccata</i> L.
20. <i>Nymphaea alba</i> L.	40. <i>Tilia argentea</i> L.

Para viteve '90, grumbullimi dhe përpunimi i bimëve pas vjeljes mbështeteshin mbi praktika të grumbullimit që menaxhoheshin nga shteti, i cili gjithashtu drejtonte dhe aktivitetin eksportues.

Pas viteve '90, ndryshimi i sistemit u shoqërua me një varfërim të popullsisë së zonave rurale, të cilët intensifikuan grumbullimin e bimëve aromatike-mjekësore dhe situata doli jashtë kontrollit.

Sipas të dhënave, në fillim të viteve 90, rreth 90% e bimëve të destinuara për tregun ndërkombëtar mbledheshin në gjendje të egër dhe pothuajse pa kontroll. Për rjedhojë, shumë habitate të specieve pas viteve '90 u degraduan dhe një pjesë e tyre po shkojnë drejt zhdukjes. Kjo ka ardhur për faktin se vjelësit disa bimë nuk i grumbullojnë duke i korrur, por duke i shkullur me gjithë rrënjë, gjë që e pengon ripërtëritjen e mëvonshme të tyre.

Faktorë të tjerë që ndikojnë në erozionin gjenetik të bimëve aromatike dhe mjekësore konsiderohen dhe zjarret, që kanë prekur sipërfaqe të mëdha; shtrirja e bujqësisë, shpyllëzimet, prerjet pa kriter, prania e infrastrukturave (hapja e rrugëve, instalimi i linjave etj). Këto janë arsye të rëndësishme për reduktimin habitateve të rritjes së bimëve aromatike dhe mjekësore. Gjithashtu, erozioni i tokës ndikon në zvogëlimin e sasisë së bimëve mjekësore veçanërisht në toka shpatore; kushtet ekstreme të motit (thatësira dhe përmbytjet) çojnë në humbjen e biodiversitetit të bimëve, pra, dhe të bimëve aromatike mjekësore; edhe mungesa e pjalmuesve (bletë etj.) ndikon në reduktimin e sasive të farave dhe të shpërndarjes së tyre.

Shpesh mungon ndërgjegjësimi i kompanive grumbulluese dhe eksportuese për impaktin afatgjatë të veprimeve të tyre, të cilat janë të motivuara nga përfitimi ekonomik. Kjo shoqërohet dhe me paditurinë e grumbulluesve rreth biologjisë së bimëve dhe vjeljes në masën e duhur, gjë që ndikon në shkatërrimin e bimësisë në tërësi. Gjithashtu, mos-eficienca e përpunimit, praktikat e parregullta të materialit të papërpunuar (tharja dhe ruajtja e papërshtatshme, mundësia e ndotjeve etj.) ndikojnë që produkti të mos ketë uniformitet si dhe të ketë humbje të herbës së tharë dhe normalisht edhe të të ardhurave.

1.2 Sistemi i Zonave të Mbrojtura Mjedisore (SZMM) në Shqipëri

Zonat e mbrojtura konsiderohen mjete të rëndësishme për menaxhimin e ekosistemit, të habitateve e llojeve. Kur menaxhohen mirë: mbrojnë strukturën, funksionin, paprekshmërinë e

një segmenti të ekosistemit apo të habitateve; rrisin njohjen, kuptimin e ekosistemeve dhe të habitateve; funksionojnë si zbutës kundër shfrytëzimit nga njeriu, keqmenaxhimit, ndotjes dhe dëmtimeve të integritetit ekologjik. Zonat e mbrojtura janë rezervate natyrore të ruajtjes së biodiversitetit të bimëve. Ato përfaqësojnë habitatet kryesore të bimëve aromatike dhe mjekësore dhe shërbejnë njëkohësisht si rezervate natyrore për ruajtjen në kushte natyrore të florës së egër.

Qeveria e Shqipërisë ka miratuar një Sistem të Zonave të Mbrojtura Mjedisore (SZMM). Aktualisht sipërfaqja e Rrjetit të Zonave të Mbrojtura (RrZM) të Shqipërisë arrin në 504,826.3ha, mbi 17.56% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Nga sipërfaqja e përgjithshme, Zonat e Mbrojtura Bregdetare e Detare (ZMBD) përbëjnë 119,224.7ha, ose 23.6% të sipërfaqes së përgjithshme të RrZM të vendit, nga e cila 13,261.2ha është vetëm sipërfaqe detare. Po kështu, 98,180.6ha, janë me statusin e zonave Ramsar, të cilat kapin 3.42% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit.

Baza e këtij sistemi konsiston kryesisht në:

- 2, Rezervat Strikt Natyrore/RSN (4,800ha);
- 14, Park Kombëtar/PK (230,707.20ha);
- 721 njësi me statusin e Monument Natyre/MN (1,970.0ha);
- 24, Rezervat Natyror i Menaxhuara/Park Natyror/RNM/PN (151,770.40ha);
- 6, Peizazh i Mbrojtur/PM (97,333.60ha)
- 4, Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara/ZMBM (18,245.00ha).

Tabela 1 Rrjeti i ZMM, sipas Kategorive IUCN

Nr.	KATEGORIA/IUCN	Nr.	Sip. Ha	%
1	Rezervat Strikt Natyror (I) 0.95%	2	4,800.0	0.95%
2	Park Kombëtar (II)	14	230,707.2	45.75%
3	Monument Natyre (III)	718	1,970.0	0.39%
4	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (IV)	24	151,770.4	30.06%
5	Peizazh i Mbrojtur (V)	6	97,333.6	19.28 %
6	Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara (VI)	4	18,245.0	3.61%
7	TOTALI	768	504,826.3	100.00%

Burimi: AKZM, 2019

REZERVAT NATYROR I MENAXHUAR/PARK NATYROR (RNM/PN) – KATEGORIA IV, IUCN


Sipas IUCN, kategoria IV,

Për të siguruar kushte natyrore të nevojshme për të mbrojtur lloje, grup llojesh dhe komunitete biotike me rëndësi kombëtare ose veçori fizike të mjedisit, për të cilat kërkohet një manipulim i veçantë nga ana e njeriut, mund të lejohet një shfrytëzim i kontrolluar i disa resurseve.

Ligji 81/2017

Shpallen territoret që përfaqësojnë zona me ndërhyrje aktive të njeriut për qëllime menaxhimi të llojeve dhe habitateve, në mënyrë që të garantohet ruajtja e habitateve dhe të plotësohen kërkesat specifike të llojeve me rëndësi rajonale e vendore, si dhe zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore.

Harta e ZMM të Shqipërisë



Burimi: AKZM, 2018

2. Vlerësimi i biodiversitetit të bimëve aromatike dhe mjekësore (BAM) në zonën e mbrojtur Korab-Koritnik (KKPA)

2.1 Rezervati Natyror i Menaxhuar/Parku Natyror Korab – Koritnik

Zona Korab-Koritnik është Rezervat Natyror i Menaxhuar (RNM)/Park Natyror (PN), Kategoria IV-t (IUCN), me sipërfaqje 55,550.2ha (555.5 km²), miratuar me VKM nr.898, datë 21.12.2011.



Harta Nr.2 Menaxhimi dhe shfrytëzimi i territorit të zonës së ekosistemit natyror malor “Parku Natyror Korab - Koritnik” .

Burimet natyrore të ekosistemit natyror malor “Parku Natyror Korab - Koritnik” janë paraqitur në hartën Nr 2.

Ekosistemi Natyror Malor “Parku Natyror Korab – Koritnik” është pjesë e rajonit alpin apo malor, që përfshihet në rajonet e Kukësit dhe Dibrës. Parku shtrihet nga kufijtë e Kosovës në Shqipërinë Verilindore deri në malin e Deshatit në kufirin jugor me Maqedoninë e Veriut.

Korabi është një masiv i lartë malor i karakterizuar në pjesën veriore të tij, nga peisazhi tipik alpin me maja të thepisura shkëmbore, ndërsa peisazhi i pjesës jugore është më i butë. Maja më e lartë e vargmalit të Korabit, është maja e Golemit, Korab (2764 m), e cila është maja më e lartë e Shqipërisë dhe një nga më të lartat në Ballkan.

Habitati më i bollshëm brenda zonës është zona e kullotave dhe livadheve, që zënë rreth 22,578.4 ha. Ky habitat përbëhet kryesisht nga kullota natyrore, toka shqopore dhe bimësi barishtore. Pyjet e vendosura kryesisht në pjesën veriore të parkut natyror dhe në pjesën lindore-jugore të territorit mbulojnë rreth 19,264 ha. Tokat bujqësore në përgjithësi ndodhen afër fshatrave të banuara, këto zënë afërsisht 8,670.9 ha në parkun natyror.

Një lloj tjetër habitati brenda parkut kombëtar përbëhet nga zona malore shkëmbore dhe toka të gërryera, të cilat së bashku zënë rreth 4,530.8 ha. Këto janë zona të hapura pa ose pak mbulesë bimore.

Zonat urbane ndodhen kryesisht në juglindje të zonës afër kufijve të parkut natyror. Këto zona mbulojnë një sipërfaqe të kufizuar (385.6 ha) të sipërfaqes totale të mbrojtur.

Sipërfaqet ujore (lumenj, përrenj, liqene, ujëmbledhës), brenda Parkut Natyror zënë rreth 120.6 ha të sipërfaqes së përgjithshme të parkut.

Rreth 19,000 banorë, që përfaqësojnë një pjesë shumë e vogël e popullsisë së qarqeve Kukës dhe Dibër, jetojnë brenda kufijve të pjesës natyrore. Banorët e këtij rajoni malor kanë të ardhura të ulëta dhe janë të prekur seriozisht nga papunësia.

Pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet me kullota e livadhe, të ndjekura nga sipërfaqet pyjore e me bimësi pyjore, sipërfaqet joproduhuese, sipërfaqet bujqësore, si dhe sipërfaqet urbane e troje të përziera me tokë bujqësore e pyjore. Për zonën e mbrojtur është kryer vetëm digjitalizimi i kufirit, duke përdorur hartat topografike në shkallë 1:25000 të gjeoreferencuara me sistemin koordinativ Gauss Kruger, si më poshtë: Në Veri: Pika 1, me koordinata 4455778.15L-4659256.82V, pranë Urës së lumit Luma, ndjek kanalin e Lumës, ndërpret lumin e Lumës, i ngjitet kurrizit ndërmjet fshatit Përbreg dhe qafës së Zbinecit, vijon me kuotat 462.6m, 1549.0m, 1361.0m, 1293.0m, 1223.0m, 1150.1m, 1021.0m, zbret kurrizin deri te pika 2, me koordinata 4463004.61L-4668805.51V, pranë Morinës; Në Lindje: Pika 2, me koordinata 4463004.61L-

4668805.51V, pranë Morinës, vijon përgjatë kufirit shtetëror me Kosovën dhe Maqedoninë deri te pika 3, kuota 2174.7m, me koordinata 4463238.36L-4605429.25V; Në Jug: Pika 3, kuota 2174.7m, me koordinata 4463238.36L-4605429.25V, vijon përgjatë kufirit shtetëror me Maqedoninë deri te pika 4, me koordinata 4459468.97L-4603467.39V; Në Perëndim: Pika 4, me koordinata 4459468.97L-4603467.39V, vijon përgjatë rrugës në drejtim të fshatit Kllobçisht, kalon në anën e poshtme të fshatit Kërçishti i Epërm, sipër fshatit Kërçishti i Poshtëm dhe fshatit Pocesti, ndjek përroin e Hollobukut, vijon në drejtim të fshatit Popinare, në drejtim të kuotës 1026.0m (k. Tuma Punjos), kalon poshtë kuotës 1474.9m, ndërpret përroin e Melanit, ngjitet kurrizit në drejtim të fshatit Ilnica, vijon me kuotat 1500.0m, 1504.0m (m.Buravajkut), 1474.6m (m.Grevës), ndjek rrugën në drejtim të kuotës 837.0m, ndërpret përroin e Banjave (pranë Llixhave), i ngjitet kurrizit të malit të Staravecit, kalon qafën e Malit, kuotën 1635.0m, ndjek kurrizin e malit të Vakufit dhe të Gramës, ndjek rrugën në livadhet e Vrenjtit, kuotën 1626.0m, kurrizin e faqes së Gradishtës, kuotat 1345.0m (k.Mëllezës) e 1034.0m, ndërpret përroin e Gramës, kalon sipër fshatit Dipjakë, në kodrën e Frizmajt, ndjek rrugën për në fshatin Venisht, ndërpret përroin e Shëngjergjit, kuota 1250.0m, ndjek rrugën sipër fshatit Sllatinë, kuota 1016.8m (m. Guri i Zi), vijon me rrugën, ngjitet kurrizit mbi fshatin Vleshë, kuota 1135.0m, 1241m, ndjek rrugën e zbret kurrizin, kalon mbi urën e lumit të Radomirës, vijon me lumin e Veleshicës, më pas i ngjitet kurrizit, kuota 1017.3m, kalon poshtë fshatit Cereni, ndërpret përroin e Rasës, ndjek rrugën, kuotat 1161.0m, 1159.0m, 1167.0m, 1187.0m, ndjek rrugën poshtë majës së Sukës (1289.0m), ndërpret përroin e Bushtricës, ndjek përroin e Vasijas, kalon nëpër degën e djathtë të rrjedhës së tij, ndërpret përroin e Ahut dhe ndjek degën e djathtë të tij (kufiri midis Dibrës e Kukësit), pranë fshatit Bushtrica (Gjanaj), kuota 1442.8m (m.Baklit), vijon përgjatë kurrizit, ndërpret përroin e Çajës, ndjek degën e krahut të djathtë të tij, kuota 1413.8m (m.Mollës), ndjek rrugën, kuota 1452.0m (m.Bakisë), vijon përgjatë rrugës, kuota 1582.0m, vijon me rrugën, kuota 1522.0m, kalon në qafën e Dardhës, kuota 1515.0m (m.Kumashit), vijon përgjatë kurrizit dhe rrugës, ndërpret përroin e Tërshanës, në grykën e kanionit të Bicajt, vijon përgjatë rrugës sipër fshatit Nanga, Nanga (Krezë) dhe Shtiqen, më pas ndjek kanalin e Lumës deri te pika 1, me koordinata 4455778.15L-4659256.82V, pranë Urës së lumit Luma.

Tabela 2. Sipërfaqja e përdorimit të territorit të RNM “Korab-Koritnik”, sipas VKM.

Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja në ha		
		Qarku Kukës	Qarku Dibër	TOTALI
1	Sip pyjore, shkurre, ripyllëzime, tokë me bimësi pyjore dhe ujore	10,081.9	7,430.7	18,412.6
2	Sip kullosore e livadhe	13,026.2	9,104.0	22,130.2
3	Sip bujqësore (arë, pemtore)	3,716.2	1,309.3	5,025.5
4	Sip ujore (lumenj, përrenj, liqene, ujëmbledhë)	33.3	9.4	42.7
5	Sip joprodhuese (shkëmbore, zhavorishte e zhveshur)	6,857.8	2,759.3	9,617.1
6	Sip urbane dhe troje të përzier me tokë bujqësore, pyjore e kullosore	271.4	50.7	322.1
	Sipërfaqe e Përgjithshme	34,886.8	20,663.4	55,550.2

Tabela 3. Tipet e habitateve të RNM “Korab-Koritnik”

KODI	Tipi i Habitatit
40	Shqopishte dhe kaçube të zonave me klimë të moderuar
4060	Shqopishte të zonave alpine dhe boreale me Juniperus communis subsp. Nan
51	Kaçubishte sub-mesdhetare dhe të zonave me klimë të moderuar
5110	Formacione të eurasian37s37 kserotermofile me bush (Buxus sempervirens) në shpate shkëmbore
61	Kullota natyrore
6170	Kullota alpine të rajoneve me natyrë gëlqerore
65	Kullota mesofile
6510	Livadhe të zonave të ulëta (Alopecurus pratensis, Sanguisorba officinalis)
6520	Livadhe të zonave malore
82	Shpate shkëmbore me vegetacion hazmofitik
8210	Shkëmbinj gëlqerorë të brendshëm të populluar nga vegetacion hazmofitik
8215	Shkëmbinj të thepisur gëlqerorë të zonave alpine dhe submesdhetare
90	Pyje të Europës Boreale
9010	Tajga Perendimore
91	Pyje të Europës me klimë të moderuar

9130	Pyje ahu neutrofile (Asperulo-Fagetum)
9110	Pyje ilirike të përzier dushku dhe shkoze (Erythronio-Carpinion)
91M0	Pyje të përzier dushqesh {kryesisht qarri (Quercus cerris), shparthi (Q. Frainetto) dhe bunge (Q. Petraea)} të Panonisë dhe Ballkanit
92	Pyje gjetherënës Mesdhetarë
9220	*Pyje ahu të Apenineve me bredh të bardhë Abies alba
925A	Pyje me mëllezë, shkozë dhe pyje të përzier termofilë
95	Pyje malorë halorësh Mesdhetarë dhe të Makaronezisë
9530	* Pyje halorësh (Sub-) Mesdhetarë të dominuar nga pisha e zezë endemike (Pinus 38uras)
9540	*Pyje mesdhetarë pishash endemike Mesogeane të zonave të larta malore, ku përfshihen Pinus mugo dhe Pinus leucodermis
J1.6	Zona të banuara (qytete dhe fshatra) dhe zona industriale të braktisura
I1.3	Toka me kultura bujqësore jo të përziera, me intensitet të ulët përdorimi të teknologjive bujqësore

2.2 Resurset gjenetike të bimëve mjekësore dhe aromatike në Rezervatin Natyror të Menaxhuar Korab-Koritnik

Në rezervatin natyror Korab – Koritnik janë të evidentuara rreth 511 lloje të ndryshme bimësh fanerogame. Nga të cilat, 316 specie nga 52 familje janë të klasifikuara si bimë mjekësore dhe aromatike. Pra, BMA-të zënë rreth 61.8% të florës së zonës së mbrojtur Korab Koritnik. Nga këto 2 bimë; zhabina e degenit dhe zhabina e vetsheinit janë bimë endemike, që gjenden vetëm në Parkun Kombëtar Korab – Koritnik. Ndërsa 6 bimë të tjera janë bimë subendemike që për veç zonës së Korabit gjenden në Alpet Shqiptare, në Qafështamë ose në Pogradec.

Në tabelën në vijim jepet lista e plotë e BMA-ve të kësaj zone:

Tabela 4: Lista e BMA-ve të zonës së mbrojtur Korab – Koritnik

Nr	FAMILIA/Specia	Emri ne Anglisht	Emri ne shqip	Direktivat e Habitaveve Annexes	Statusi i kërcënimit IUCN	Komente
I	Acanthaceae					
1	<i>Acanthus spinosus</i>	Spiny Bear's Breech	Dashtë gjembore	-	-	
II	Adoxaceae					

2	<i>Sambucus ebulus</i>	Dwarf Elder	Qingël	-	-	
3	<i>Sambucus nigra</i>	Blue Elder	Shtog i zi, shtog	II/IV	VU A1b	
III	Anacardiaceae					
4	<i>Cotinus coggygia</i>	Young Fustic	Cemërdell	-	-	
IV	Apiaceae					
5	<i>Carum carvi</i>	Caraway	Karabotit karvi	-	-	
6	<i>Chaerophyllum aromaticum</i>	Broad Leaved Chervil	Stërpujë e merme	-	-	
7	<i>Daucus carota</i>	Wild Carrot		-	LC	
8	<i>Eryngium amethystinum</i>	Amethyst Eryngo	Gjembardhë ngjyrë ametisti	-	-	
9	<i>Eryngium campestre</i>	Sea Holly	Gjembardhë fushash	-	-	
10	<i>Eryngium creticum</i>	Small Headed Blue Eryngo	Gjembardhë e Kretës	-	-	
11	<i>Levisticum officinale</i>	Lovage	Levistik mjekësor	-	-	
12	<i>Peucedanum officinale</i>	Sulphurwort	Selin mjeksor	-	-	
13	<i>Peucedanum schottii</i>	Schot's Fennel	Selin i Skotit	-	-	
14	<i>Pimpinella nigra</i>	Black Burnet	Pimpinellë e zezë	-	-	
15	<i>Pimpinella peregrina</i>	Southern Burnet Saxifrage	Pimpinellë shtegtare	-	-	
16	<i>Pimpinella saxifraga</i>	Burnet saxifrage	Pimpinellë iriqëz	-	-	
17	<i>Pimpinella tragiun</i>	Rock burnet	Pimpinellë shkëmbinjsh	-	-	
18	<i>Tordylium officinale</i>	Common hartwort	Tordilë mjekësore	-	-	
V	Araceae					
19	<i>Arum italicum</i>	Large Cuckoo Pint	Kelkazë e Italisë	-	-	
VI	Araliaceae					
20	<i>Hedera helix</i>	Ivy	Urth	-	-	
VII	Aspleniaceae					
21	<i>Asplenium adiantum-nigrum</i>	Black Spleenwort	Fier i zi	-	-	
22	<i>Asplenium cuneifolium</i>	Serpentine Spleenwort	Fier gjethe pykë	-	-	
23	<i>Asplenium fissum</i>	Cloven Spleenwort	Fier i çarë	-	-	
24	<i>Asplenium lepidum</i>	Tender Spleenwort	Fier i bukur	-	-	
25	<i>Asplenium septentrionale</i>	Forked Spleenwort	Fier verior	-	-	
26	<i>Asplenium trichomanes</i>	Maidenhairspleenwort	Fier me qime	-	-	
27	<i>Asplenium viride</i>	Green Spleenwort	Fier i blertë	-	-	
28	<i>Ceterach officinarum</i>	Rustyback Fern	Bargjarpër mjeksor	-	-	
VIII	Asteraceae					
29	<i>Achillea atrata</i>	Black yarrow	Barpezmi e Kluzit	-	-	
30	<i>Achillea collina</i>	Hill Yarrow	Barpezmi kodrinor	-	-	
31	<i>Achillea millefolium</i>	Yarrow	Njemijfleteshi	-	-	

32	<i>Anthemis altissima</i>	Tall Chamomile	Syviç shumë i lartë	-	-	
33	<i>Anthemis arvensis</i>	Corn Chamomile	Syviç i arave	-	-	
34	<i>Anthemis austriaca</i>	Austrian Chamomile	Syviç austriak	-	-	
35	<i>Anthemis cotula</i>	Wild Chamomile	Maraq	-	-	
36	<i>Arctium minus</i>	Lesser Burdock	Rrodhe e vogël	-	-	
37	<i>Arctium lappa</i>	greater burdock	Rrodhe			
38	<i>Arctostaphylos uva-ursi</i>	Bearberry	Rrush i ariut		LR cd	
39	<i>Artemisia absinthium</i>	Green Ginger	Pelin	-	-	
40	<i>Artemisia alba Turra</i>	White Sage	Pelin i bardhë	-	-	
41	<i>Artemisia campestris</i>	Sage	Pelin i fushës	II/IV	NT	
42	<i>Artemisia petrosa</i>	White Genep	Pelin si ombrellë			
43	<i>Artemisia vulgaris</i>	Mugwort	Pelin i rëndomtë	-	-	
44	<i>Bellis annua</i>	Annual Daisy	Luleshqerrë njëvjeçare	-	-	
45	<i>Bellis perennis</i>	Lawndaisy	Lulesheqerrë shumëvjeçare	-	-	
46	<i>Bellis sylvestris</i>	Wood Daisy	Lulesheqerre pyjore	-	-	
47	<i>Carlina acaulis</i>	Stemless Carlina Thistle	Ushonjëz e pakërcelltë	-	-	
48	<i>Carlina corymbosa</i>	Clustered Carlina Thistle	Ushonjëz vastakore	-	-	
49	<i>Carlina vulgaris</i>	Carlina Thistle	Ushonjëz e rëndomtë	-	-	
50	<i>Centaurea benedicta</i>	Blessed Thistle	Kokoçel i shenjtë	-	-	
51	<i>Centaurea calcitrapa</i>	Star Thistle	Kokoçel yjor	-	-	
52	<i>Centaurea cyanus</i>	Cornflower	Cian			
53	<i>Centaurea candelabrum</i>	Candelabrum Thistle	Kokoçel si shandan	-	EN A1b	Endemic: Alps, Korabi
54	<i>Centaurea jacea</i>	French Hardhead	Kokoçel i rënë	II/IV	VU	
55	<i>Centaurea pannonica</i>	Hungarian Thistle	Kokoçel i Panonisë	-	-	
56	<i>Centaurea phrygia</i>	Wig Knapweed	Kokoçel i Frigias	-	-	
57	<i>Centaurea solstitialis</i>	Yellow Star Thistle	Gjemb i bardhë	-	-	
58	<i>Cichorium endivia</i>	Escarole	Çikore	-	-	
59	<i>Cichorium intybus</i>	Zikorifa	Kore	-	LC	
60	<i>Cirsium arvense</i>	Canada Thistle	Gjembi i arave	-	-	
61	<i>Cirsium erisithales</i>	Yellow Thistle	Cirzë erisital	-	-	
62	<i>Cirsium palustre</i>	Marsh Thistle	Cirzë kënetore	-	-	
63	<i>Cirsium vulgare</i>	Spear Thistle	Gjemb gomari	-	-	
64	<i>Cyanus triumfettii</i>	Axillary Knapweed, Felty Knapweed	Kokoçel i Triumfetit			
65	<i>Erigeron acer</i>	Blue Fleabane	erigeron i adhët	-	-	
66	<i>Erigeron alpinus</i>	Alpine Erigeron	erigeron i Alpeve	-	-	
67	<i>Hieracium hoppeanum</i>	Eastern Mouse Ear Hawkweed	Këmashën hopeanë	-	-	
68	<i>Inula britannica</i>	Yellow Starwort	Plenër britanike	-	-	

69	<i>Inula ensifolia</i>	Narrow Leaved Inula	Plenër gjetheshpatë	-	-	
70	<i>Inula salicina</i>	Willow Leaved Inula	Plenër shëlgore	-	-	
71	<i>Lactuca muralis</i>	Wall Lettuce	Marule muresh	-	LC	
72	<i>Lactuca perennis</i>	Mountain Lettuce	Marule shumëvjeçare	-	DD	
73	<i>Lactuca saligna</i>	Willowleaf Lettuce	marule shëlgore	-	LC	
74	<i>Lactuca serriola</i>	Prickly Lettuce	Ogrisht	-	LC	
75	<i>Lactuca viminea</i>	Pliant Lettuce	marule thuprore	-	LC	
76	<i>Leucanthemum vulgare</i>	Oxeye Daisy	Lulemargaritë	-	-	
77	<i>Onopordum acanthium</i>	Scotch Thistle	xhixhëll dashter	-	-	
78	<i>Onopordum illyricum</i>	Illyrian Thistle	xhixhëll e Ilirisë	-	-	
79	<i>Pilosella hoppeana</i>	Eastern Mouse Ear Hawkweed	Këmashën hopeanë	-	-	
80	<i>Pilosella officinarum</i>	Mouseear Hawkweed	Këmashën mjeksor	-	-	
81	<i>Pilosella piloselloides</i>	Kingdevil	Këmashën leshatak	-	-	
82	<i>Pulicaria dysenterica</i>	Meadow False Fleabane	Plenër dizanterike	-	-	
83	<i>Pulicaria odora</i>	Mediterranean Fleabane	Plenër me aromë	-	-	
84	<i>Pulicaria vulgaris</i>	Small Fleabane	Plenër e rëndomtë	-	-	
85	<i>Scorzonera austriaca</i>	Austrian Viper's Grass	Skorzonerë austriake	-	-	
86	<i>Scorzonera hispanica</i>	Black Salsify	Skorzonerë e Spanjës	-	-	
87	<i>Senecio doronicum</i>	Chamois Ragwort	Pulith doronike	-	-	
88	<i>Serratula tinctoria</i>	Dyer's Plumeless Saw-wort	Serratulë ngjyruese	-	-	
89	<i>Silybum marianum</i>	Variegated Thistle	Gjembgomari	-	-	
90	<i>Solidago virgaurea</i>	European Goldenrod	Solidagë shufërtartë	-	-	
91	<i>Sonchus arvensis</i>	Field Sowthistle	Rrëshyell arash	-	-	
92	<i>Sonchus asper</i>	Spiny Leaved Sow Thistle	Rrëshyell i ashpër	-	-	
93	<i>Sonchus oleraceus</i>	Sowthistle	Rrëshyell perimesh	-	-	
94	<i>Tanacetum vulgare</i>	Tansy	Karajpel			
95	<i>Taraxacum campylodes</i>	Swines Snout	Luleshurdhë e zakonshme	-	-	
96	<i>Taraxacum officinale</i>	Common Dandelion	Lule shurdha			
97	<i>Tragopogon pratensis</i>	Yellow Goatsbeard	Lulebrigje e livadhit	-	-	
98	<i>Tussilago farfara</i>	Coughwort	Thundërmushkë	-	-	
99	<i>Tussilago hybrida</i>	Coltsfoot	Llapi			
100	<i>Xeranthemum inapertum</i>	Xeranthemum	Kserantemë e paçelur	-	-	
IX	Berberidaceae					
101	<i>Berberis vulgaris</i>	Sowberry	Mylqinë	-	-	
102	<i>Epimedium alpinum</i>	Barrenwort	epimedë alpine	-	-	
X	Betulaceae					
103	<i>Alnus glutinosa</i>	European Alder	Verri i zi	-	-	

104	<i>Carpinus betulus</i>	Ironwood	Shkozë e bardhë	-	-	
105	<i>Carpinus orientalis</i>	Oriental Hornbeam	Shkozë e zezë	-	-	
106	<i>Corylus avellana</i>	Common Hazel	Lajthi	-	NT	
XI	Boraginaceae					
107	<i>Anchusa arvensis</i>	Bugloss	Gjuhëlopë arash	-	-	
108	<i>Anchusa undulata</i>	Undulate Alkanet	Gjuhlope e valëzuar	-	-	
109	<i>Asperugo procumbens</i>	German-madwort	Gjuhë kau.	-	-	
110	<i>Buglossoides arvensis</i>	Corn Gromwell	Buglosoide arash	-	-	
111	<i>Cerinth glabra</i>	Smooth Honeywort	Qirinthë e shogët	-	-	
112	<i>Cerinth major</i>	Honeywort	Qirinthë e madhe	-	-	
113	<i>Cerinth minor</i>	Lesser Honeywort	Qirinthë e vogël	-	-	
114	<i>Cynoglossum creticum</i>	Blue Hound's Tongue	Gjuhëqen e Kretës	-	-	
115	<i>Cynoglossum germanicum</i>	Green Hound's Tongue	Gjuhëqen e Gjermanisë	-	-	
116	<i>Cynoglossum officinale</i>	Common Hound's Tongue	Gjuhëqen mjeksore	-	-	
117	<i>Echium italicum</i>	Pale Bugloss	ushqerëz e Italisë	-	-	
118	<i>Echium parviflorum</i>	Small Flowered Bugloss	ushqerëz lulevogël	-	-	
119	<i>Echium plantagineum</i>	Salvation Jane	ushqerëz si dejç	-	-	
120	<i>Echium vulgare</i>	Viper's Bugloss	Gjuhënepërkë	-	-	
121	<i>Heliotropium europaeum</i>	Turnsol	Diellidridhës i Europës	-	-	
122	<i>Lithospermum officinale</i>	European Stoneseed	Kokërrujë mjekësore	-	-	
123	<i>Moltkia doerfleri</i>	Doerfler Moltkia	Moltke e Derflerit	-	VU	Endemic: Alps, Korabi
124	<i>Myosotis arvensis</i>	Rough Forget Me Not	Lulemizë arash	-	-	
125	<i>Myosotis discolor</i>	Yellow Forget Me Not	Lulemizë çngjyruese	-	-	
126	<i>Myosotis ramosissima</i>	Early Forget Me Not	Lulemizë shumë e degëzuar	-	-	
127	<i>Myosotis sylvatica</i>	Woodland Forget Me Not	Lulemizë pyjesh	-	-	
128	<i>Onosma echioides</i>	Onosma	çikllë si ushqerëz	-	-	
129	<i>Pulmonaria officinalis</i>	Common Lungwort	Bar i mushkërisë	-	-	
130	<i>Symphytum bulbosum</i>	Bulbous Comfrey	Kufilmë qepore	-	-	
131	<i>Symphytum tuberosum</i>	Tuberous Comfrey	Kufilmë zhardhokore	-	-	
XII	Brassicaceae					
132	<i>Aethionema saxatile</i>	Burnt Candytuft	Etionemë shkëmbinjësh	-	-	
133	<i>Alliaria petiolata</i>	Garlic Mustard	Bar hudhre	-	-	
134	<i>Armoracia rusticana</i>	Horse Radish	Kren	-	LC	
135	<i>Barbarea vulgaris</i>	Garden Yellowrocket	Barbarea e rendomtë	-	LC	
136	<i>Biscutella didyma</i>	Mediterranean Biscutella	Biskutelë binjake	-	-	
137	<i>Brassica nigra</i>	Black Mustard	Lakër e zezë	-	LC	

138	<i>Bunias erucago</i>	Southern Warty Cabbage	Brokër	-	-	
139	<i>Calepina irregularis</i>	White Ball Mustard	Kalepinë e çrregullt	-	-	
140	<i>Camelina rumelica</i>	Graceful False Flax	Kamelinë	-	LC	
141	<i>Camelina sativa</i>	Gold of Pleasure	Kamelinë e kultivuar	-	DD	
142	<i>Capsella bursa-pastoris</i>	Shepherd's Purse	Trasta e çobanit	-	-	
143	<i>Capsella grandiflora</i>	Large flowers Shepherd's Purse	Shtrapër lulemadhe	-	-	
144	<i>Capsella rubella</i>	Pink Shepherd's Purse	Shtrapër e kuqe	-	-	
145	<i>Cardaria draba</i>	Hoary cress	Bosht i plakës	-	-	
146	<i>Clypeola jonthlaspi</i>	Disk Cress	Klipeolë	-	-	
147	<i>Conringia orientalis</i>	Hare's Ear Mustard	Konringë e Lindjes	-	-	
148	<i>Draba muralis</i>	Wall Whitlowgrass	Drabë muresh	-	-	
149	<i>Erysimum odoratum</i>	Smelly Wallflower	Erisimë e merme	-	-	
150	<i>Fibigia clypeata</i>	Fibigia	Fibigë me mburojë	-	-	
151	<i>Hesperis cupaniana</i>	Cut Leaved Dame's Violet	Hesperidë	-	-	
152	<i>Hesperis matronalis</i>	Rocket	Hesperidë shkëmbore	-	-	
153	<i>Iberis sempervirens</i>	Evergreen Candytuft	Iberis breshke	-	-	
154	<i>Iberis umbellata</i>	Globe Candytuft	Iberis ombrellore	-	-	
155	<i>Lepidium campestre</i>	Field Pepperwort	Djegës fushash	-	LC	
156	<i>Lepidium graminifolium</i>	Tall Pepperwort	Djegës gjethegrami	-	LC	
157	<i>Lepidium latifolium</i>	Dittander	Djegës gjethegjërë	-	LC	
158	<i>Lepidium ruderae</i>	Narrow Leaved Pepperwort	Djegës i gërmadhavë	-	LC	
159	<i>Lepidium virginicum</i>	Medium Pepperweed	Djegës i virgjër	-	-	
160	<i>Lunaria annua</i>	White Money Plant	Barhënë njëvjecare	-	-	
161	<i>Lunaria rediviva</i>	Perennial Honesty	Barhënë shumëvjecare	-	-	
162	<i>Neslia paniculata</i>	Ball Mustard	neslie melthore	-	-	
163	<i>Peltaria alliacea</i>	Garlic cress	Peltare me erë hudhre	-	-	
164	<i>Raphanus raphanistrum</i>	Wild Radish	Rrapanidhe	-	LC	
165	<i>Rapistrum rugosum</i>	Bastard Cabbage	Rrepicë e rrudhur	-	-	
166	<i>Sinapis alba</i>	Yellow Mustard	Sinap i bardhë	-	LC	
167	<i>Sisymbrium altissimum</i>	Tall Tumblemustard	Cucubinë shumë e lartë	-	-	
168	<i>Sisymbrium officinale</i>	Hedgemustard	Cucubinë mjekësore	-	-	
169	<i>Sisymbrium orientale</i>	Indian Hedgemustard	Cucubinë e lindjes	-	-	
170	<i>Sisymbrium polyceratum</i>	Shortfruit Hedgemustard	Cucubinë shumëbrirëshe	-	-	
171	<i>Thlaspi alliaceum</i>	Garlic Pennycress	Tlasp hudhror	-	-	
172	<i>Thlaspi arvense</i>	Field Pennycress	Tlasp arash	-	-	
173	<i>Thlaspi mycophyllum</i>	Small Leaved Penny-cress	Tlasp gjethevogël	-	-	

174	<i>Thlaspi perfoliatum</i>	Perfoliate Pennycress	Tlasp nëpërgjethës	-	-	
XIII	Buxaceae					
175	<i>Buxus sempervirens</i>	English Boxwood	Bush	-	-	
XIV	Campanulaceae					
176	<i>Asyneuma comosiforme</i>	Comose Harebell	Asineumë balukengjashme	-	VU	Endemic: Alps, Korabi
177	<i>Asyneuma limonifolium</i>	Harebell	Asineumë gjethelimoni	-	-	
178	<i>Campanula alpina</i>	Alpine Bellflower	Lulekambanë e Alpeve	-	-	
179	<i>Campanula bononiensis</i>	Pale Bellflower	Lulekambanë e Bolonjës	-	-	
180	<i>Campanula glomerata</i>	Clustered Bellflower	Lulekambanë lëshshukë	-	-	
181	<i>Campanula latifolia</i>	Large Bellflower	Lulekambanë gjethegjerë	-	-	
182	<i>Campanula patula</i>	Spreading Bellflower	Lulekambanë e hapur	-	-	
183	<i>Campanula persicifolia</i>	Peach Leaved Bellflower	Lulekambanë gjethepjeshke	-	-	
184	<i>Campanula rapunculoides</i>	Creeping Bellflower	Lulekambanë si fitemë	-	-	
185	<i>Legousia hybrida</i>	Venus Looking Glass	Leguzie hibride	-	-	
186	<i>Phyteuma orbiculare</i>	Round Headed Rampion	Fiteumë e rrumbullakët	-	-	
XV	Caprifoliaceae					
187	<i>Lonicera alpigena</i>	Alpine Honeysuckle	Bardhaqen	-	-	
188	<i>Lonicera etrusca</i>	Etruscan Honeysuckle	Dorëzonjë etruske	-	-	
189	<i>Lonicera xylosteum</i>	Fly Honeysuckle	Dorëzonjë drufortë	-	-	
XVI	Dipsacaceae					
190	<i>Dipsacus fullonum</i>	Teazel	Berunzë e butë	-	-	
191	<i>Dipsacus laciniatus</i>	Cut leaved Teasel	Berunzë e rripëzuar	-	-	
192	<i>Knautia arvensis</i>	Field Scabiosa	Knautë arash	-	-	
193	<i>Knautia dipsacifolia</i>	Wood Scabious	Knautë gjetheberunzë	-	-	
194	<i>Scabiosa atropurpurea</i>	Mourningbride	Skabiozë purport e errët	-	-	
195	<i>Scabiosa columbaria</i>	Yellow Scabious	Skabiozë pëllumb	-	-	
196	<i>Scabiosa lucida</i>	Shining Scabious	Skabiozë e shndritshme	-	-	
197	<i>Succisa pratensis</i>	Devil's Bit Scabious	Suçizë livadhesh	-	-	
XVII	Dryopteridaceae					
198	<i>Dryopteris filix-mas</i>	Male-Fern	Fieri mashkull		LRcd	
XVIII	Valerianaceae					
199	<i>Centranthus ruber</i>	Red Valerian	Centrantë e kuqe	-	-	
200	<i>Valeriana montana</i>	Mountain Valerian	Haraqinë malore	-	-	
201	<i>Valeriana officinalis</i>	Valerian	Haraqinë mjeksore	-	-	
202	<i>Valerianella carinata</i>	Keeled Fruited Cornsalad	Heraqinëz karenore	-	-	

203	<i>Valerianella coronata</i>	Crown Cornsalad	Heraqinëz e kurorëzuar	-	-	
204	<i>Valerianella dentata</i>	Narrow Fruited Cornsalad	Heraqinëz e dhëmbëzuar	-	-	
205	<i>Valerianella eriocarpa</i>	Hairy Fruited Cornsalad	Heraqinëz frytleshtake	-	-	
206	<i>Valerianella locusta</i>	Lewiston Cornsalad	Heraqinëz karkalece	-	-	
XIX	Caryophyllaceae					
207	<i>Agrostemma githago</i>	Common Corncockle	Kënkol	-	-	
208	<i>Arenaria serpyllifolia</i>	Thyme Leaved Sandwort	Arenare gjethe lisre	-	-	
209	<i>Cerastium alpinum</i>	Alpine Mouse Ear	Cerast alpesh	-	-	
210	<i>Cerastium arvense</i>	Field Chickweed	Cerast arash	-	-	
211	<i>Cerastium grandiflorum</i>	Bering Chickweed	Cerast lulemadh	-	VU	
212	<i>Dianthus carthusianorum</i>	Carthusian Pink	Karafil Karthuzian	-	-	
213	<i>Drypis spinosa</i>	Drypis	Dripëz me gjemba	-	-	
214	<i>Herniaria glabra</i>	Glabrous Rupturewort	Herniarie pa qime	-	-	
215	<i>Herniaria hirsuta</i>	Hairy Rupturewort	Herniarie kreshtake	-	-	
216	<i>Herniaria incana</i>	Gray Rupturewort	Herniarie e thinjur	-	-	
217	<i>Holosteum umbellatum</i>	Jagged Chickweed	Holoste umbrellor	-	-	
218	<i>Lychnis coronaria</i>	Rose Champion	Lulekrahoshi	-	-	
219	<i>Saponaria bellidifolia</i>	Spoon Leaved Soapwort	Sapunqyqe gjethebukur	-	-	
220	<i>Saponaria officinalis</i>	Bouncingbet	Lule sapuni	-	-	
221	<i>Scleranthus annuus</i>	Annual Knawel	Sklerantë njëvjeçare	-	-	
222	<i>Scleranthus perennis</i>	Perennial Knawel	Sklerantë shumëvjeçare	-	-	
223	<i>Silene armeria</i>	Sweet William Silene	Klokëz skorleq	-	-	
224	<i>Spergula arvensis</i>	Corn Spurry	Spergulë arash	-	-	
225	<i>Spergularia rubra</i>	Red Sandspurry	Spergularë e kuqe	-	-	
226	<i>Stellaria graminea</i>	Lesser Stitchwort	Stelare gramore	-	-	
227	<i>Stellaria media</i>	Common Chickweed	Stelare e ndërmjetme	-	-	
228	<i>Stellaria neglecta</i>	Greater Chickweed	Stelare e papërfillur	-	-	
XX	Celastraceae					
229	<i>Euonymus europaeus</i>	Spindle Tree	Shikakuq	-	-	
XXI	Parnassiaceae					
230	<i>Parnassia palustris</i>	Marsh Grass of Parnassus	Parnasë moçalesh	-	-	
XXII	Plantaginaceae					
231	<i>Digitalis lanata</i>	Grecian foxglove	Lule filxhani		LR cd	
XXIII	Polygonaceae					
232	<i>Polygonum albanicum</i>	Albanian Knotgrass	Nejçë shqiptare		CR	Endemic: Alps , Korabi
233	<i>Polygonum aviculare</i>	Common knotgrass	Barpate			

XXIV	Primulaceae					
234	<i>Primula veris</i>	Cowslip	Agulice			
235	<i>Primula elatior</i>	Oxlip	Agulice			
XXV	Chenopodiaceae					
236	<i>Chenopodium album</i>	Lambsquarters	Minuer i bardhë	-	-	
237	<i>Chenopodium ambrosioides</i>	Wormseed	Minuer si ambrozie	-	-	
238	<i>Chenopodium botrys</i>	Sticky Goosefoot	Minuer ngjitës	-	-	
XXVI	Colchicaceae					
239	<i>Colchicum autumnale</i>	Naked Lady	Xhërrokull vjeshtore	-	EN A1b	
XXVII	Cornaceae					
240	<i>Cornus mas</i>	Cornelian Cherry	Thanë	-	-	
XXVIII	Crassulaceae					
241	<i>Hylotelephium telephium</i>	Witch's Moneybags	Rrushqyqe e Telefit	-	-	
242	<i>Sedum acre</i>	Wall Pepper	Rrushqyqe e adhët	-	-	
XXIX	Cupressaceae					
243	<i>Juniperus communis</i>	Common Juniper	Dëllinjë e zezë	-	VU A1b	
244	<i>Juniperus oxycedrus</i>	Sharp Cedar	Dëllinjë e kuqe	-	VU A1b	
XXX	Ericaceae					
245	<i>Vaccinium myrtillus</i>	Common Bilberry	Boronicë	-	VU A2b	
246	<i>Vaccinium uliginosum</i>	Bog bilberry	Boronicë qeni		VU A1c	
XXXI	Fabaceae					
247	<i>Astragalus fialea</i>	milk-vetch	Arithe e Fiales	-		
248	<i>Anthyllis montana</i>	Mountain anthyllis	Antilidë e malit			
249	<i>Trifolium aurantiacum</i>	Orange Colour's Clover	Trifil ngjyrë portokalli	-		
250	<i>Trifolium campestre</i>	Hop Trefoil	Trifil fushash	-		
251	<i>Trifolium pilczii</i>	Pilczy Clover	Trifil i Pilcit	-		
252	<i>Trifolium pretense</i>	Red Clover	Tërfili i kuq			
XXXII	Gentianaceae					
253	<i>Gentiana lutea</i>	Great Yellow Gentian	Gencianë, Sanzi	-	EN A1b	
254	<i>Gentiana cruciata</i>					
XXXIII	Geraniaceae					
255	<i>Erodium guicciardii</i>	Guicciardi Stork's-bill	erodë e Giçardit	-	EN A1b	
256	<i>Geranium dalmaticum</i>	Dalmatian Cranesbill	Kamaroshe e Dallmacisë	-	LR nt	
XXXIV	Juglandaceae					
257	<i>Juglans regia</i>	Walnut	Arra		EN A1b	
XXXV	Fabaceae					
258	<i>Melilotus officinalis</i>	Sweet clovers	Makth mjekësor			
258	<i>Ononis spinosa</i>	Restharrow	Gjuhë nuse			
XXXVI	Lamiaceae or Labiatae					

260	<i>Origanum vulgare</i>	Oregano	Caj Mali, Rigon	-	EN A1b	
261	<i>Thymus serpyllum</i>	Breckland thyme	Lisër si pulegë	-		
262	<i>Melissa officinalis</i>	Lemon Balm	Bar blete			
263	<i>Mentha longifolia</i>	Mint	Mendra			
264	<i>Mentha pulegium</i>	commonly pennyroyal	Mendra pulegë			
265	<i>Salvia officinalis</i>	Sage	Sherebela		VU Alb	
266	<i>Salvia sclarea</i>	Clary sage	Shëngjini			
267	<i>Satureja montana</i>	Savoury mountain	Trumza		VU A1c	
268	<i>Teucrium chamaedrys</i>	Wall germander	Arrsi dushk			
269	<i>Teucrium polium</i>	Felty germander	Bar majasëlli			
270	<i>Thymus serpyllum</i>	Breckland thyme	Zhumbrica			
XXXVII	Rhamnaceae					
271	<i>Rhamnus alpinus</i>	Alpine Buckthorn	arrë i egër			
XXXVIII	Hypericaceae					
272	<i>Hypericum perforatum</i>	Perforate St. John's Wort	Lulebasani		EN A1b	
273	<i>Hypericum montanum</i>	Pale St. Johan's Wort	Lulebalsan malesh			
XXXIX	Iridaceae					
274	<i>Iris pseudacorus</i>	Yellow iris plant	Shpatore		VU A2b	
XL	Liliaceae					
275	<i>Colchicum pieperanum</i>	Pepper's naked lady	Xhërrokull e Piperit	-	VU	Endemic: Korabi, Qafe Shtamë
276	<i>Colchicum autumnale</i>	Autumn crocus	Xhërokull vjeshtor		EN A1b	
XLI	Linaceae					
277	<i>Linum spathulatum</i>	Spathulate Flax	Lin pallak	-	-	
XLII	Malvaceae					
278	<i>Althaea officinalis</i>	Marshmallow plant	Mellage e bardhe			
279	<i>Tilia platyphyllos</i>	Linden	Bliri i kuq		CR Alc	
280	<i>Tilia tomentosa</i>	Silver linden	Bliri i argjende			
XLIII	Oleaceae					
281	<i>Fraxinus excelsior</i>	Common Ash	Frashër i zi	-	CR A1b	
282	<i>Fraxinus ornus</i>	Ash	Frashër i bardhë			
XLIV	Papaveraceae					
283	<i>Papaver rhoeas</i>	Common poppy	Lulekuqja			
XLV	Pinaceae					
284	<i>Pinus heldreichii</i>	Bosnian pine	Rrobull		VU D2	
285	<i>Pinus nigra</i>	Black Pine	Pishë e zezë	-	-	
XLVI	Plantaginaceae					
286	<i>Plantago lanceolata</i>	Ribwort Plantain	Gjethe delli			
287	<i>Plantago major</i>	broadleaf plantain	Gjethe delli			

288	<i>Plantago media</i>	hoary plantain	Gjethe delli			
XLVII	Ranunculaceae					
289	<i>Ranunculus degeni</i>	Degen Buttercup	Zhabinë e Degenit	-	LR cd	Endemic: Korabi
290	<i>Ranunculus wettsteinii</i>	Wettstein Buttercup	Zhabinë e Vetshteinit	-	CR B2a	Endemic: Korabi
291	<i>Ranunculus croaticum</i>	Croatian Ranunculus	Zhabinë kroate	-	-	
XLVIII	Rosaceae					
292	<i>Alchemilla catachnoa</i>	Lady's mantle	Alkemilë kataknoe	-	EN A1b	
293	<i>Crataegus heldreichii</i>	Heldreichi Thornapple	Murriz i Hedreihit	-	LR cdsaxi	
294	<i>Crataegus monogyna</i>	Hawthorns	Murrizi njëbërthamëz			
295	<i>Fragaria vesca</i>	Wild strawberry	dredhez			
296	<i>Potentilla erecta</i>	Common Tormentil	Potentillë e ngritur	-	-	
297	<i>Potentilla visianii</i>	Visiani's Cinquefoil	Potentillë e Visianit	-	-	
298	<i>Prunus spinosa</i>	Blackthorn	Kulumbri	-	LC	
299	<i>Rosa canina</i>	Dog Rose	Trëndafil qeni	-	-	
300	<i>Malus sylvestris</i>	Wilder Apple	Mollë e egër			
301	<i>Rubus caesius</i>	Dewberry	Manaferrë kaltëroshe			
302	<i>Rubus ulmifolius</i>	Elm Leaf Blackberry	Ferrëmanëza			
303	<i>Rubus idaeus</i>	Raspberry	Mjedra			
304	<i>Sorbus aucuparia</i>	Rowan	Vodhja e egër			
305	Rubiaceae					
306	<i>Galium verum</i>	Lady's bedstraw	Ngjitese e vertete			
XLIX	Sapindaceae					
307	<i>Acer opalus</i>	Italian Maple	Panjë Italiane	-	-	
L	Urticaceae					
308	<i>Urtica dioica</i>	Common nettle	Hithër	-	LC	
LI	Orchidaceae					
309	<i>Orchis albanica</i>	Orchis	salep		EN A1b	
310	<i>Orchis morio</i>	Anacamptis morio	salep			
311	<i>Orchis provincialis</i>	Provence orchid	salep		LR cd	
LII	Violaceae					
312	<i>Viola ducadjinica</i>	Ducadjin Violet	Manushaqe e Dukagjinit	-	LR cd	Endemic: Alps, Korabi, Pogradec
313	<i>Viola elegantula</i>	Less elegant Violet	Manushaqe pak elegante	-	LR nt	
314	<i>Viola speciosa</i>	Pretty Violet	Manushaqe e bukur	-	-	
315	<i>Viola beckiana</i>	Beck's Violet	Manushaqe e Bekut	-	EN A1b	
316	<i>Viola odorata</i>	Sweet Violet	Manushaqe	-		

Vlen të theksohet se 32 bimë të klasifikuara si bimë mjekësore janë të përfshira në Listën e Kuqe të Florës së Shqipërisë. Për të kuptuar më mirë, na vjen në ndihmë tabela në vijim.

Tabela 5: Lista e BMA-ve në rrezik zhdukjeje


Nr	FAMILIA/Specia	Emri ne Anglisht	Emri ne shqip	Statusi i kërcënimit IUCN
1	<i>Alchemilla catachnoa</i>	Lady's mantle	Alkemilë kataknoe	EN A1b
2	<i>Arctostaphylos uva-ursi</i>	Bearberry	Rrush i ariut	LR cd
3	<i>Asyneuma comosiforme</i>	Comose Harebell	Asineumë balukengjashme	EN A1b
4	<i>Barbarea vulgaris</i>	Garden Yellowrocket	Barbarea e rendomtë	VU A1b
5	<i>Centaurea candelabrum</i>	Candelabrum Thistle	Kokoçel si shandan	EN A1b
6	<i>Cerastium grandiflorum</i>	Bering Chickweed	Cerast lulemadh	EN A1b
7	<i>Colchicum autumnale</i>	Naked Lady	Xhërrokull vjeshtore	EN A1b
8	<i>Colchicum pieperanum</i>	Pepper's naked lady	Xhërrokull e Piperit	EN A1b
9	<i>Crataegus heldreichii</i>	Heldreichi Thornapple	Murriz i Hedreihit	LR cdsaxi
10	<i>Erodium guicciardii</i>	Guicciardi Stork's-bill	erodë e Giçardit	EN A1b
11	<i>Fraxinus excelsior</i>	Common Ash	Frashër i zi	CR A1b
12	<i>Gentiana lutea</i>	Great Yellow Gentian	Gencianë, Sanzi	EN A1b
13	<i>Geranium dalmaticum</i>	Dalmatian Cranesbill	Kamaroshe e Dallmacisë	LR nt
14	<i>Hypericum perforatum</i>	Perforate St. John's Wort	Lulebasani	EN A1b
15	<i>Iris pseudacorus</i>	Yellow iris plant	Shpatore	VU A2b
16	<i>Juglans regia</i>	Walnut	Arra	EN A1b
17	<i>Juniperus communis</i>	Common Juniper	Dëllinjë e zezë	VU A1b
18	<i>Juniperus oxycedrus</i>	Sharp Cedar	Dëllinjë e kuqe	VU A1b
19	<i>Orchis albanica</i>	Orchis	salep	EN A1b
20	<i>Orchis provincialis</i>	Provence orchid	salep	LR cd
21	<i>Origanum vulgare</i>	Oregano	Caj Mali, Rigon	EN A1b
22	<i>Pinus heldreichii</i>	Bosnian pine	Rrobull	VU D2
23	<i>Ranunculus degeni</i>	Degen Buttercup	Zhabinë e Degenit	LR cd
24	<i>Ranunculus wettsteinii</i>	Wettstein Buttercup	Zhabinë e Vetshteinit	CR B2a
25	<i>Salvia officinalis</i>	Sage	Sherebela	VU A1b
26	<i>Sambucus nigra</i>	Blue Elder	Shtog i zi, shtog	VU A1b
27	<i>Satureja montana</i>	Savoury mountain	Trumza	VU A1c

28	<i>Tilia platyphyllos</i>	Linden	Bliri i kuq	CR Alc
29	<i>Vaccinium myrtillus</i>	Common Bilberry	Boronicë	VU A2b
30	<i>Vaccinium uliginosum</i>	Bog bilberry	Boronicë qeni	VU A1c
31	<i>Viola ducadjinica</i>	Ducadjin Violet	Manushaqe e Dukagjinit	LR cd
32	<i>Viola elegantula</i>	Less elegant Violet	Manushaqe pak elegante	LR nt

Në një ndarje të shkallës së kërcënimit të BMA-ve të zonës Korab – Koritnik, kemi këtë panoramë:

- **Status Të rrezikuara në rrezik zhdukjeje (CR).** Janë 3 specie bimore kanë statusin kritik të zhdukjes: frashëri i zi, zhabina e vetsheinit dhe bliri i kuq.
- **Status I rrezikuar (EN).** Janë 12 bimë vaskulare kanë statusin e bimëve të rrezikuara: alkemila kataknoe, kokoceli si shandan, xhërrokulli vjeshtor, erodë e gëçardit, sanzi, lulebasani, arra, salepi, rigoni dhe manushaqja e bekut.
- **Statusi I Përkeqësuar/vulnerabël (VU).** Janë 10 bimë të larta me statusin vulnerabël. Nga këto mund të shquajmë bimë të tilla si: dëllinja e zezë, dëllinja e kuqe, sherebela, shtogu, trumza dhe boronica (qershigla).
- **Statusi Më pak i Rrezikuar LC ose LR** – në rrezik më të ulët. Këto janë të përfshira gjithsej 7 specie ku spikasin: rrushi i ariut, fieri, kulumbria, hithra, manushaqja e dukagjinit, etj.

Grafiku në vijim na ndihmon për të kuptuar se si janë të ndara bimët në rrezik zhdukjeje sipas shkallës së IUCN.



Grafiku 2: Klasifikimi sipas ndarje të shkallës së kërcënimit të BMA-ve të zonës Korab – Koritnik, të përfshira në Listën e Kuqe të Florës së Shqipërisë.



3. Vlerësimi i potencialit prodhues të BMA-ve në KKPA dhe situata e kultivimit të tyre

3.1 Përvoja e vendit tonë në grumbullimin dhe përdorimin e bimëve aromatike e mjekësore dhe gjendja e tyre para viteve 90

Në vendin tonë ka traditë që në kohët e hershme për grumbullimin dhe përpunimin e bimëve aromatike e mjekësore sidomos në rrethet Malësi e Madhe, Kukës, Dibër, Elbasan, Berat, Skrapar, Përmet dhe Gjirokastrë. Studiusja angleze, Edith Durham, në shkrimet e saj, fliste për banorët e zonave të veriut dhe të jugut të cilët shquheshin për mjekimin e plagëve nga bimët mjekësore. Pas viteve 1950 në Shqipëri funksiononte Instituti i Mjekësisë Popullore i cili ka kryer shumë kërkime e studime për zhvillimin e njohurive për bimët aromatike e mjekësore. Në saj të kërkimit shkencor në këtë fushë, në shumë farmaci sot tregtohen një numër bimësh me vlera të larta kurative dhe të efekshme për shërimin e shumë sëmundjeve. Grumbullimi, tregëtimi dhe përdorimi i bimëve aromatike e mjekësore në vendin tonë është mjaft i hershëm, eksporti i tyre ka filluar në fund të viteve 60 të shekullit të kaluar.

Para viteve 1990 puna për mbarshtimin e bimëve aromatike e mjekësore ishte e organizuar në shkallë rrethi në të gjithë territorin e vendit, shfrytëzimi bëhej i kontrolluar dhe tregtimi në tregjet botërore ishte në nivele të larta. Deri në vitin 1990 eksportoheshin rreth 165 specie mjekësore dhe aromatike, taninë dhe esenca të florës spontane dhe të kultivuar. Në këtë periudhë nisi gjithashtu edhe kultivimi i rreth 10 bimëve mjekësore dhe aromatike dhe sipërfaqet e mbjella ishin më shumë se 3000 ha të shpërndara në disa zona të vendit të specializuara në kultivimin e bimëve. Para viteve '90, thuajse në çdo rreth u krijuan ndërmarrjet e grumbullim-përpunimit dhe ndërmarrjet pyjore, si dhe disa ndërmarrje përpunimi ku ishin instaluar distilatorë. Rrjeti i furnizimit në periudhën e komunizmit ishte i organizuar shumë mirë përmes kompanisë së vetme shtetërore që ishte Albanian Import Export (AlbImpEx) të administruar nga qeveria, e cila kryente lidhjet mes tregjeve botërore për shitjen e bimëve mjekësore dhe erëzave. Gjatë kësaj periudhe vlera e eksporteve shkonte rreth 60-70 milion USD në vit. Deri në vitin 1990, Shqipëria ka qenë një nga eksportuesit më të mëdhenj të bimëve etero-vajore dhe mjekësore të egra në Evropë.

Për të zgjeruar e rritur më shumë kujdesin ndaj këtyre bimëve në vitin 1988 nga ish Instituti i Kërkimeve të Pyjeve dhe Kullotave (IKPK) u hartua **Inventari Kombëtar** për të gjitha speciet që kultivohen në vendin tonë. Inventari ka përshkruar llojet që rriten në vendin tonë, përhapjen e tyre në zonat fitoklimatike të përshtatshme, prodhimtarinë potenciale dhe mundësitë e të ardhurave nga këto bimë nëse do të shfrytëzoheshin e të mbarshtoheshin me kritere shkencore.

3.2 Vjelja dhe grumbullimi i BMA-ve të zonës Korab Koritnik para viteve '90

Në një vlerësim të kryer në vitin 1988 nga IKPK, në zonën Korab Koritnik, Dibër, janë mbledhur dhe eksportuar rreth 91 bimë mjekësore dhe aromatike. Sasia totale e BMA-ve e eksportuar në këtë vit ka qënë 5,374 ton e cila ka gjeneruar një vlerë prej 1,124 milionë \$.

Në ditët e sotme, mblidhen apo grumbullohen 63 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike në këtë zonë. Nga BMA-të që mblidhen sot, 16 prej tyre kanë janë të klasifikuara në një nga statuset e rrezikimit sipas IUCN-së. Më konkretisht:

- Status kritik (CR). Janë 3 bimë që kanë statusin të zhdukjes: frashëri i zi, mështekna dhe bliri.
- Status në rrezik (EN). Janë 5 bimë që kanë statusin e bimëve të rrezikuara: alkemila kataknoe, sanzi, lulebasani, arra, dhe rigoni (çaji i malit).
- Statusi vulnerabël (VU). Janë 7 bimë me statusin vulnerabël: dëllinja e zezë, dëllinja e kuqe, shpatorja, sherebela, shtogu, trumza dhe boronica (qershigla).
- Statusi pranë rrezikimit (NT). Nuk ka BMA që grumbullohen sot me këtë status.
- Statusi LC ose LR – në rrezik më të ulët. Këto është e përfshirë një specie: rrushi i ariut.

Pasqyra përmbledhëse në vijim na ndihmon për të njohur për të krijuar një ide rreth bimëve mjekësore të rrethit të Dibrës që janë mbledhur para viteve 1990-të, bashkë me sipërfaqen në hektar, sasinë në ton, përfshirë dhe vlerën në US\$ të asaj kohe (IKPK, 1988), si dhe nëse mblidhen ende sot, sasinë në ton dhe shkalla e kërcënimit.

Tabela 6: BMA-të e grumbulluara para viteve '90 dhe sot në zonën Korab Koritnik, Dibër

Nr	Emri Shkencor	Emri popullor	Pjesët e bimes/Organi	Sip. ha	Sasia ton	Vlera / Value, x 1000 US\$	Grumbullohet Sot (Po/Jo)	Prodhimi i mundshëm per grumbullim (ton)	Statusi i kërcënimit
	Likene								
1	Lichen fagus	Myshk ahu	Myshk	-	5	2	Jo	2-3	
2	Lichen planus	Myshk pishe	Myshk	-	20	10	Jo	5-10	
3	Lichen quercus	Myshk dushku	Myshk	-	2	1	Jo	1-2	
	Gjimnosperme								
4	Abies alba	Bredhi i bardhë	Hala	96	237	3	Jo	20-3-	

5	Juniperus communis	Dëllënjë e zezë	Fryt	2825	66	66	Po	80-100	VU Alb
6	Juniperus oxycedrus	Dëllënjë e kuqe	Fryt	671	18	38	Po	40-50	VU A1b
7	Pinus heldreichii	Rrobull	Hala	40	320	3	Jo	30-40	VU D2
8	Pinus nigra	Pishë e zezë	Hala	379	950	9	Jo	30-40	
	Angiosperme								
9	Achillea millefolium	Njëmijë fletësh	Lule/herb	-	14	7	Po	5-6 / 10-15	
10	Aesculus hippocastanum	Gështoja e kalit	Lëvore	-	0.2	0.2	Jo	-	CR A1a
11	Althaea officinalis	Mëllaga e bardhë	Lule	-	0.2	1	Po	1-1.5	
12	Alchemilla catachnoa	Alkemilë kataknoe	Herb				Po	juni	EN A1b
13	Arctium lappa	Rrodhe	rrënjë, gjethe, fara	-	1	1.5	Po	1	
14	Anthyllis montana	Antilidë e malit	Herb	-			Po		
15	Arctostaphylos uva-ursi	Rrush i arushës	Fletë	-			Po	10-15	LR cd
16	Artemisia absinthium -	Pelini bar	Herb	-			Po	-	
17	Bellis perennis	Lule shqerre	Lule	-	1	1	Po	2-3	
18	Betula pendula	Mështekna	Fletë	40	18	7	Po	8-10	CR B2e
19	Capsella bursa	Torba e bariut	Herb	-	12.2	6	Jo	4-5	
20	Castanea sativa	Gështenja	Fletë	185	30	10	Po	5-10	
21	Carlina vulgaris	Ushonjës e rëndomtë	Rrenje				Po	30-40	
22	Centaurea cyanus	Kokoçeli -	Lule	-	1.8		Po	0.5-1	
23	Cichorium intybus	Çikore	Rrenje	122	2.7	5.5	Jo	05.-1	
24	Corylus avellana	Lajthia	Fletë, fryt	2093	263	112	Po	5-10	
25	Cotinus coggygria	Cemredelli	fletë, bisqe	138	30		Jo	5-10	
26	Crataegus monogyna	Murrizi njëbërthamëz	Lule/ fryt	-	2.7	12	Po	5-6 / 8-10	
27	Crataegus oxyacantha	Murrizi dybërthamëz	lule, gjethe, fryt	-	3.1	3	Po	8-10	
28	Colchicum autumnale	Xhërokull vjeshtor	Rrenje				Po		
29	Cynodon dactylon	Grami	Rrënjë	166	41.8	21	Po	3-5	
30	Datura stramonium	Tatulla	Fletë	-	2	1	Jo	05-1	

31	Dryopteris filixmas	Fier mashkull	Fletë						LRcd
32	Digitalis lanata	Lule filxhani	Fletë	-	0.1		Jo		LR cd
33	Fragaria vesca	Luleshtrydhja	Gjethe, rrenje, fryte	-	6	7	Po	3-5	
34	Fraxinus excelsior	Frashër i zi	Fletë	3	1	0.25	Po	-	CR A1b
35	Fraxinus ornus	Frashër i bardhë	Fletë	203	12	4	Po	-	
36	Galium verum	Ngjitese e vertete	Herb				Po	-	
37	Gentiana lutea	Sanzi	Rrënjë	-	10	26	Po	-	EN A1b
38	Iris sp	Shpatore	Rrënjë				Po		VU A2b
39	Helichrysum arenarium	Lule aku	Lule	-	1.07	4	Po	-	
40	Hypericum perforatum	Lule basani	Herb	-	3	4	Po	15-20	EN A1b
41	Juglans regia	Arra	Gjethe, levore	358	330	162	Po	5-10	EN A1b
42	Malus sylvestris	Molla e egër	fryte, lule, gjethe	-	14.2	8	Po	8-10	
43	Melilotus officinalis	Jonxha e egër	Herb	-	1.3	1	Po	-	
44	Melissa officinalis	Melisa	Herb		0.4		Po	-	
45	Mentha longifolia	Mendra	Herb	-	12.2	5	Jo	8-10	
46	Mentha pulegium	Mendra pulegë	Herb	-	0.2		Jo	-	
47	Ononis spinosa	Gjuhë nuse	Rrënjë	-	8	9	Po	3-5	
48	Origanum vulgare	Caj Mali	Herb	-	0.6	0.3	Po	1-2	EN A1b
49	Papaver rhoeas	Lulekuqja	Lule	-	1.1	5	Po	1.5-2	
50	Parietaria officinalis	Parietaria	Herb	-	1	1	Po	0.5	
51	Phaseolus vulgaris	Fasule	Lëvore	700	13	6	Po	-	
52	Plantago lanceolata	Gjethe delli	Fletë	-	4	3	Po	1-2	
53	Plantago major	Gjethe delli	Fletë	-	2	1	Po	4-5	
54	Plantago media	Gjethe delli	Fletë	-	2	2	Po	05-1	
55	Polygonum aviculare	Barpate	Herb	34	6	3	Po	4-5	
56	Populus nigra	Plepi i zi	Sytha	2	1.1		Jo	-	
57	Primula grandiflora	Agulicja	Bar	-			Jo	-	
	(Primula vulgaris)							15-20	
58	Primula veris (=P. Officinalis)	Agulicia	Lule	-	8	38	Po	-	
59	Prunus cerasus (=Cerasus vulgaris)	Qershia	Bishtat	37	0.6	1	Po	1-2	

60	Prunus spinosa	Kulumbria	lule, fryt	-	7.4	9	Po		
61	Rhamnus alpinus	Arrë i egër					Jo	5-10	
62	Robinia pseudoacacia	Akacia	Lule	541	12	10	Po	20-30	
63	Rosa canina	Trëndafili i egër	Fryt	2092	68	34	Po	-	
64	Rubus caesius	Ferra	Fryt	-			Jo	5-10	
65	Rubus fruticosus	Ferrëmanëza	Fletë, fryt	-	29	20	Po	15-20	
66	Rubus idaeus	Mjedra	Fletë, fryt	80	15.6	10	Po	-	
67	Salix alba	Shelgu i bardhë	thupra, levore	-			Po	10-20	
68	Salix nigra	Shelgu i zi	Thupra	112	672	47	Jo	10-15	
69	Salix ssp.	Shelgje te tjera	Thupra	153	1408	98	Jo	10-15	VU A1b
70	Salix viminalis	Shelgu industrial	thupra, levore	35	420	29	Jo	25-30	
71	Salvia officinalis	Sherebela	Herb	783	30	24	Po	-	VU Alb
72	Salvia sclarea	Shëngjini	Herb	-			Po	15-20	
73	Sambucus ebulus	Qingël	Rrënjë	18	27	10	Po	10 -15 / 8-10	
74	Sambucus nigra	Shtogu	Lule/ fryt,	-	3.2	7	Po	-	VU Alb
75	Saponaria officinalis	Lule sapuni	Rrënjë	-	0.2		Po	5-6	
76	Satureja montana	Trumza	Herb	-	80	17 5	Po	-	VU A1c
77	Sorbus aucuparia	Vodhja e egër	Fryt	-	0.2	0.2	Jo	10-15	
78	Tanacetum vulgare	Karajpel	Herb				Po	30-40	
79	Taraxacum officinale	Lule shurdha	fletë, rrenje	23	1.5		Po	-	
80	Teucrium chamaedrys	Arrsi dushk	Herb	-	7	4	Po	1-2	
81	Teucrium polium	Bar majasëlli	Herb	197	5.4		Jo	2-5	
82	Thymus serpyllum	Zhumbrica	Herb	222	18.6	12	Po	-	
83	Tilia platyphyllos (=T. officinarum)	Bliri	lule, gjethe	-	0.5	1	Po	-	CR Alc
84	Tilia tomentosa (=T. argentea)	Bliri i argjentë	Lule	-	1	3	Po	15-20	
85	Trifolium pretense	Tërfili i kuq	Lule	-			Po	3-4	
86	Tussilago farfara	Thundërmushka	lule, gjethe	-	9	6	Po	-	
87	Tussilago hybrida (=Syn. P. officinalis)	Llapoi	Rrënjë	-			Po	10-15	
88	Urtica dioica	Hithër	rrënjë, gjethe	17	13	6	Po	40-50/8-10	

89	Vaccinium myrtillus	Qershigla, boronica	Gjethe, fryt	2500	65	184	Po		VU A2b
90	Verbascum sp	Netulla	Lule				Jo		EN A1b
91	Viola odorata	Manushaqe					Po	2-3	

Të dhëna të përgjithshme për vjelësit pranë zonës Korab-Koritnik


Për të bërë një vlerësim të drejtë të mbledhjes spontane të bimëve aromatike dhe mjekësore (BMA) në Zonën e Mbrojtur Korab – Koritnik u zhvilluan intervista me vjelës nga zonat më tipike të bimëve mjekësore dhe aromatike në fshatrat e njësive administrative: Muhurr, Melan, Maqellare, Kastriot dhe Sllovë.

Në tabelën e mëposhtme jepet në mënyrë të përmblendhur popullsia që jeton në këto njësi administrative:

Tabela 7: Popullsia në njësitë administrative (viti 2020) ku është kryer studimi

Njesia adm.	Popullsia totale	Nr. familje	M	F	1 - 18 vjec	18 - 40 vjec	40 - 50 vjec	50 - 60 vjec	> 60 vjec
Muhurr	3,245	1,025	1,740	1,505	808	1,272	429	388	348
Melan	4,330	1,237	2,248	2,082	1,160	1,541	595	553	481
Maqëllare	14,297	3,886	7,398	6,899	4,035	5,243	2,076	1,636	1,307
Kastriot	7,379	2,230	3,825	3,554	1,906	2,860	1,005	877	731
Sllovë	2,792	952	1,455	1,337	665	1,113	378	353	283
Total	32,043	9,330	16,666	15,377	8,574	12,029	4,483	3,807	3,150

Në këto pesë njësi administrative të parkut kombëtar Korab – Koritnik jetojnë 32,043 banorë, nga të cilët 16,666 meshkuj dhe 15,377 femra (*Instat 2020*). Gjithsej janë 9,330 familje. Njësia më e madhe administrative është ajo e Maqëllarës ku jetojnë 14,297 banorë dhe e dyta në renditje vjen Kastrioti me 7,379 banorë.



Grafiku 3: Shpërndarja e popullsisë sipas grupmoshave

Vlen të theksohet ndarja e popullsisë sipas grupmoshave, ku bie në sy përqindja e lartë e të rinjve: 26.8% e popullsisë është nën 18 vjeç, ndërkohë që mosha e re dhe më aktive për punë 18 – 40 vjeç përbën 37.5% të popullsisë totale në këto 5 njësi administrative. Popullsia e moshës 40 – 50 vjeç, zë 14% të totalit, mosha 50 – 60 vjeç zë 11.9% të popullsisë dhe së fundmi mosha mbi 60 vjeç përbën 9.8% të totalit të popullsisë në këto 5 njësi administrative të përfshira në këtë studim.

U përgatitën dy pyetësore, një për vjelësit e BMA_ve të florës spontane dhe një pyetësor për grumbulluesit dhe përpunuesit. Gjithsej u intervistuan 40 vjelës dhe 4 grumbullues. Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e vjelësve të intervistuar, përkatësia gjinore, grupmosha, numri i anëtarëve të familjes të përfshirë në vjelje dhe informacion nëse vjelësi është i kthyer nga emigracioni.

Tabela 8: Të dhëna të përgjithshme të vjelëse të intervistuar


Vjelesi Nr.	Njësia Adminsitrative	Fshati	Gjinia	Grup mosha 18 - 25	Grup mosha 26 - 35	Grup mosha 36 - 60	Grup mosha >60	Kthyer nga emigracioni	Nr. i anetareve te familjes
1	Muhurr	Rreth Kale	M		x			Po	2
2	Muhurr	Rreth Kale	M			x		Jo	2
3	Melan	Zagrad	M		x			Jo	2
4	Melan	Grevë	M			x		Jo	3
5	Melan	Illicë	F			x		Jo	2

6	Melan	Pejkë	M		x			Po	2
7	Melan	Zagrad	M			x		Jo	3
8	Melan	Zagrad	M		x			Jo	2
9	Melan	Zagrad	F		x			Jo	3
10	Melan	Zagrad	F		x			Jo	3
11	Melan	Trepcë	M			x		Po	2
12	Melan	Rabdisht	M			x		Po	3
13	Melan	Rabdisht	F			x		Po	3
14	Melan	Rabdisht	M			x		Po	3
15	Melan	Rabdisht	F		x			Jo	1
16	Melan	Rabdisht	M		x			Po	4
17	Maqëllarë	Pocest	M			x		Jo	2
18	Maqëllarë	Maqëllarë	M			x		Jo	3
19	Maqëllarë	Pocest	M			x		Jo	3
20	Maqëllarë	Pocest	M			x		Po	7
21	Kastriot	Sohodoll	M			x		Jo	3
22	Kastriot	Sohodoll	M		x			Jo	3
23	Kastriot	Sohodoll	F			x		Jo	5
24	Kastriot	Sohodoll	M		x			Po	3
25	Kastriot	Sohodoll	M		x			Jo	5
26	Kastriot	Vakuf	F			x		Jo	4
27	Kastriot	Vakuf	M			x		Po	3
28	Kastriot	Kishavec	M			x		Po	4
29	Kastriot	Kishavec	M		x			Jo	7
30	Kastriot	Vrejnt	F			x		Po	3
31	Kastriot	Vrejnt	F				x	Jo	3
32	Kastriot	Vrejnt	F			x		Jo	3
33	Kastriot	Vrejnt	M			x		Jo	2
34	Kastriot	Vrejnt	M			x		Po	3
35	Sllovë	Sllovë	M		x			Jo	3
36	Sllovë	Vleshë	M			x		Po	3
37	Sllovë	Palaman	M			x		Jo	5
38	Sllovë	Shumbat	M		x			Po	3
39	Sllovë	Palaman	M			x		Jo	2
40	Sllovë	Shumbat	M		x			Po	2
TOTAL					15	24	1		124

Nga 40 vjelës të intervistuar 10 prej tyre janë gra, duke përfaqësuar kështu 25% të vjelësve. Megjithatë, vlen të theksohet fakti se vjelja spontane e bimëve aromatike dhe mjekësore është

një aktivitetet që kryhet si familje, ku gratë janë gjithmonë të pranishme. Në këto 40 familje janë të përfshirë gjithsej 124 vjelës.

Për sa i përket grupmoshës së vjelësve të intervistuar, 15 prej tyre janë 26 – 35 vjeç duke përfaqësuar 37.5% të vjelësve, 24 vjelës i përkasin grupmoshës 36 – 60 vjeç me një përfaqësim prej 60% dhe vetëm 1 vjelës është mbi 60 vjeç. Këtë to dhëna tregojnë se pjesa kryesore e vjelësve i përkasin moshës së mesme, ndërkohë që dhe vjelësit me moshë të re zënë një vend të rëndësishëm. Ndërkohë, nuk ka vjelës të moshës shumë të re dhe ka shumë pak vjelës të moshuar.



Grafiku 4: Paraqitja në përqindje e vjelësve sipas grupmoshës së tyre

Vlen të theksohet se 16 prej vjelësve të intervistuar ose 40% e tyre deklarojnë se janë të kthyer nga emigracioni. Kjo nënkupton se një pjesë e madhe e vjelësve të zonës së mbrojtur Koritnik – Korab, kanë vlerësuar si mundësi vetëpunësimi përshtirjen e tyre në sektorin e BMA-ve në vendlindjen e tyre.

Në tabelën në vijim paraqitet një ndarje e treguesve për vjelësit sipas Njësive Administrative

Tabela 9: Të dhënat e vjelësve sipas Njësive Administrative

Treguesi	Muhurr	Melan	Maqellarë	Kastriot	Sllovë	Total
Intervista të zhvilluara	2	14	4	14	6	40
Gra	0	5	0	5	0	10
Grup moshë 26 - 35 vjeç	1	7	0	4	3	15

Grup mosha 36 - 60 vjeç	1	7	4	9	3	24
Grup mosha >60 vjeç	0	0	0	1	0	1
Kthyer nga emigracioni	1	6	1	5	3	16
Numri i vjelësve	4	36	15	51	18	124

Njësitë administrative ku janë intervistuar më shumë vjelës janë Melani dhe Kastrioti, përkatësisht nga 14 vjelës. Në Sllovë janë kryer 6 intervista, në Maqëllarë 4 intervista dhe së fundmi në Muhurr 2 intervista.

Numri më i lartë i grave të intervistuar është sërish në Melan dhe Kastriot, përkatësisht 5 gra. Në njësitë e tjera administrative nuk pati gra të intervistuar.

Numri më i lartë i vjelësve të intervistuar të moshës së re 26 - 35 vjeç paraqitet në Melan; 7 nga 14 vjelës. Në njësitë e tjera administrative, vjelësit e kësaj grupmoshe të re janë: 4 në Kastriot, 3 në Sllovë dhe 1 në Muhurr.

Më shumë vjelës të moshës së mesme 36 – 60 vjeç shfaqen në Njësinë administrative Kastriot: 9 nga 14 vjelës. Në Melan janë 7 vjelës së kësaj grupmoshe. Në Maqëllarë të gjithë vjelësit e intervistuar (4) i përkasin grupmoshës 36 – 60 vjeç. Së fundmi, në Sllovë dhe Muhurr janë përkatësisht 3 vjelës dhe 1 vjelës të moshës së mesme. Vjelësi i vetëm i moshuar mbi 60 vjeç vjen nga Njësia Administrative Kastriot.

Duke marrë në konsideratë numrin e vjelësve në familje, 51 prej tyre vijnë nga Njësia Administrative Kastriot dhe 36 nga Melani. Sllova dhe Maqëllara kanë përkatësisht nga 18 dhe 15 vjelës dhe së fundmi Njësia administrative Muhurr në këtë studim përfaqësohet me 4 vjelës.

3.4 Bimët e florës spontane që mbledhen në zonën e mbrojtur Korab – Koritnik

Vjelësit e intervistuar në 5 Njësitë administrative: Muhur, Melan, Maqëllarë, Kastriot dhe Sllovë janë pyetur për llojet e bimëve spontane që ata vjelin. Bazuar në deklaratimet e tyre, rezultojnë 33 bimë të tilla. Në këtë studim, do t'i analizojmë të ndara sipas Njësive administrative.

a. Njësia administrative Muhurr

Në këtë Njësi administrative vjelësit deklarojnë për tre bimë kryesore të vjela nga flora spontane: tërfil i kuq, qumështore dhe gjuhënuese. 100% e vjelësve pohojnë se vjelin kryesisht këto tre bimë nga flora spontane në Njësinë administrative Muhurr.

Tabela 10: Bimët aromatike dhe mjekësore Njësia administrative Muhurr

Nr	Bima aromatike	Numri i vjelësve të BMA-së	Përqindja e vjelësve mbi numrin total të vjelësve të intervistuar të zonës
1	Tërfil i kuq	2	100%
2	Qumështore	2	100%
3	Gjuhënuse	2	100%

b. Njësia Administrative Melan

Diversiteti dhe numri i bimëve aromatike dhe mjekësore që grumbullohen në këtë Njësi administrative është më e gjerë. Vjelësit deklarojnë për 14 BMA që vilen në këtë Njësi administrative. Në tabelën në vijim jepet një pasqyrë e përgjithshme e BMA-ve të vjela, numrin e vjelësve që pohojnë se vjelin një BMA të caktuar dhe përqindjen që zënë vjelësit e bimës mbi numrin total të vjelësve të intervistuar të kësaj zone.

Tabela 11: *Bimët aromatike dhe mjekësore Njësia administrative Melan*

Nr	Bima aromatike	Numri i vjelësve të BMA-së	Përqindja e vjelësve mbi numrin total të vjelësve të intervistuar të zonës
1	Tërfil i kuq	14	100%
2	Qumështore	8	57%
3	Qershigël	13	93%
4	Dëllinjë e zezë	12	86%
5	Salep	9	64%
6	Rigon	2	14%
7	Shtog	8	57%
8	Balsam	6	43%
9	Agulice	6	43%
10	Trumëz	2	14%
11	Drunakuq	1	7%
12	Hithër	5	36%
13	Majlink	5	36%

14	Rrënjë ferre	5	36%
----	--------------	---	-----

Të gjithë vjelësit deklarojnë se vjelin tërfil të kuq në Njësinë administrative Melan. Po kështu, 93% e tyre pohojnë se vjelin qershigël, 86% vjelin dëllinjë të zezë dhe 64% salep. Po kështu, bimë të tilla si qumështore, shtog, balsam dhe agulice mblidhen nga rreth 50% e vjelësve të intervistuar. Hithra, majlinku dhe gjethja e ferrës mblidhen nga 36% e të intervistuarve. Ndërkohë në sasi të vogla mblidhen rigoni, trumza dhe drunakuqi.

c. Njësia administrative Maqëllarë

Vjelësit e Maqëllarës deklarojnë pak a shumë të njëjat bimë aromatike dhe mjekësore si vjelësit e Melanit, me disa ndryshime të vogla. Tërfilli i kuq, qumështorja, dëllinja e zezë dhe shtogu janë bimë që mblidhen nga të gjithë vjelësit e intervistuar të Maqëllarës. Gjithashtu, qershigla, balsami, agulicja dhe hithra mblidhen gjerësisht në këtë Njësi administrative. Një numër i vogël i vjelësish pohojnë se vjelin salep dhe murriz.

Tabela në vijim paraqet një përmbledhje të të dhënave të BMA-ve të vjela në Njësinë administrative Maqëllarë.

Tabela 12: Bimët aromatike dhe mjekësore Njësia administrative Maqëllarë

Nr	Bima aromatike	Numri i vjelësve të BMA-së	Përqindja e vjelësve mbi numrin total të vjelësve të intervistuar të zonës
1	Tërfilli i kuq	4	100%
2	Qumështore	4	100%
3	Qershigël	3	75%
4	Dëllinjë e zezë	4	100%
5	Salep	1	25%
6	Shtog	4	100%
7	Balsam	2	50%
8	Agulice	2	50%
9	Hithër	2	50%

10	Murris	1	25%
----	--------	---	-----

d. Njësia administrative Kastriot

Vjelësit e Njesisë administrative Kastriot deklarojnë një gamë të gjerë të BMA-ve të vjela nga zona spontane. Janë 23 bimë aromatike dhe mjekësore që vilen në këtë Njësi administrative. Bazuar në numrin e vjelësve që deklarojnë mbledhjen e një BMA-je të caktuar, qumështorja dhe hithra janë bimët që vilen më shumti, përkatësiht nga 79% e vjelësve. Gjithashtu me rëndësi janë dhe bimë të tilla si: tërfili i kuq, dëllinja e zezë, shtogu, balsami dhe agulicja kanë peshë të madhe në këtë zonë pasi vilen nga mbi 50% e vjelësve të intervistuar të Njesisë administrative Kastriot. Në këtë zonë shfaqen edhe bimë të tjera si: trëndafil i egër, lulëkuqja, qingla, pelini, kulumbria, llapoj, thundërmushka, gjethedelli, bishtkali, lulezogu, rrush ariu, lajthia (gjethe) dhe civen.

Tabela në vijim paraqet një përmbledhje të të dhënave të BMA-ve të vjela në Njësine administrative Kastriot.

Tabela 13: Bimët aromatike dhe mjekësore Njësia administrative Kastriot

Nr	Bima aromatike	Numri i vjelësve të BMA-së	Përqindja e vjelësve mbi numrin total të vjelësve të intervistuar të zonës
1	Terfil i kuq	7	50%
2	Qumeshtore	11	79%
3	Gjuhenuse	1	7%
4	Qershigel	6	43%
5	Dëllinje e zeze	9	64%
6	Shtog	7	50%
7	Balsam	8	57%
8	Agulice	7	50%
9	Hither	11	79%
10	Rrenje ferre	2	14%
11	Trendafil i egër	3	21%
12	Lulekuqe	2	14%
13	Qingjel	3	21%
14	Pelin	1	7%
15	Kulumbri	2	14%
16	Llapoj	1	7%
17	Thundërmushke	2	14%
18	Gjethedelli	1	7%

19	Bishtkali	1	7%
20	Lulezogu	1	7%
21	Rrush ariu	5	36%
22	Gjethe lajthie	3	21%
23	Civen	3	21%

e. Njësia administrative Sllovë

Në Sllovë, hasim disa bimë aromatike dhe mjekësore sikundër dhe në zonat e analizuara më lart. Shtogu është një BMA që deklarohet se vilet nga të gjithë vjelësit e intervistuar të kësaj Njësie administrative. Po kështu, qershigla, pelini, rrushi i ariut dhe dëllenja e zezë zënë një vend të rëndësishëm. Në këtë Njësi administrative vjelësit deklarojnë disa bimë të tjera që nuk shfaqen në katër zonat e para, të tilla si: shtarë, blin, mëllage dhe njëmijëfletësh. Tabela në vijim paraqet një përmbledhje të të dhënave të BMA-ve të vjela në Njësine administrative Kastriot.

Tabela 14: Bimët aromatike dhe mjekësore Njësia administrative Sllovë

Nr	Bima aromatike	Numri i vjelësve të BMA-së	Përqindja e vjelësve mbi numrin total të vjelësve të intervistuar të zonës
1	Qershigël	4	67%
2	Dëllinjë e zezë	2	33%
3	Shtog	6	100%
4	Agulice	1	17%
5	Hithër	1	17%
6	Pelin	3	50%
7	Rrush ariu	2	33%
8	Shtarë	1	17%
9	Blin	1	17%
10	Mëllagë	1	17%
11	Njëmijëfletësh	1	17%

3.5 Sasia e bimëve aromatike dhe mjekësore të vjela nga flora spontanë parkun kombëtar Korab – Koritnik

Bazuar në të dhënat e marra nga cdo vjelës është përlogaritur sasia totale e BMA-ve për cdo njësi administrative në tre vitet e fundit. Në total, 40 vjelësit e intervistuar pohojnë të jenë vjelë 34.1 ton BMA në vitin 2020, rreth 35,4 ton BMA në vitin 2021 dhe 37.7 ton BMA në vitin 2022.

Tabela 15: Të dhënat e sasisë totale e BMA-ve për çdo njësi administrative në tre vitet e fundit

Nr	Njësia administrative	Totali 2020 (kg)	Totali 2021 (kg)	Totali 2022 (kg)
1	Muhurr	350	350	370
2	Melan	8,960	9,440	10,190
3	Maqellarë	6,700	8,500	8,100
4	Kastriot	14,500	14,300	16,000
5	Sillove	3,670	2,850	3,080
TOTAL		34,180	35,440	37,740

Në Kastriot 14 vjelësit e intervistuar kanë vjelë 16 ton BMA të thata në vitin 2022. Në Melan, kemi sërish 14 vjelës të intervistuar që kanë vjelë rreth 10.2 ton BMA në 2022. Në Maqellarë 4 vjelës pohojnë të kenë vjelë 8.1 ton BMA të thata në 2022, në Sillovë 6 vjelës kanë mbledhur 3 ton BMA të thata dhe në Muhurr, 2 vjelës nga mbledhur 0.37 ton BMA të thata.

Për një ndarje të sasisë sipas specieve të BMA-ve do të analizojmë në një kapitull tjetër të dhënat e marra nga kompanitë e grumbullit dhe përpunimit të BMA-ve.

3.6 Bimët aromatike dhe mjekësore të kultivuara në njësitë administrative Parkut Kombëtar Korab – Koritnik

Kultivimi i BMA-ve në zonën e parkut kombëtar Korab – Koritnik është në fillimet e tij. Janë shumë pak sipërfaqje të kultivuara me BMA në këtë zonë. Nga 40 vjelës të intervistuar vetëm 8 prej tyre deklarojnë sipërfaqje të vogla të kultivuara. Nga këta, 6 fermerë janë nga Njësia administrative Melan, të cilat kultivojnë tërfil të kuq në sipërfaqje të vogla 0.2 deri në 0.5 ha. Në total sipërfaqja totale e kultivuar me tërfil të kuq është 1.7 ha. Kjo është bikë shumëvjeçare e cila hyn në prodhim vitin e dytë pas mbjelljes. 5 nga këta fermerë e kanë mbjellë tërfilin në vitin 2022, i cili pritet të hyjë në prodhim vitin e ardhshëm. Vetëm një fermer pohon të ketë shitur 600 kg tërfil të thatë në vitin 2022.

Ndërkohë, një fermer në MaqVllarë pohon të këtë kultivuar 0.5 ha cian, nga e cila ka marrë një prodhim prej 600 kg dhe një fermer në Kastriot ka kultivuar 0.25 ha cian, nga e cila ka marrë 500 kg cian të thatë.

Tabela ne vijim jep një informacion të përmbledhur te kutivimeve të BMA-ve nga vjelësit e intervistuar të parkut kombëtar Korab – Koritnik.

Tabela 16: Kultivimi i BMA-ve në zonën Korab – Koritnik

Fermeri Nr.	Njësia administrative	Terfil i kuq (sip ha)	Sasia e fresket (ton)	Sasia e thate (ton)	Cian (sip ha)	Sasia e fresket (ton)	Sasia e thate (ton)
1	Melan	0.5					
2	Melan	0.3					
3	Melan	0.2	3.6	0.6			
4	Melan	0.2					
5	Melan	0.3					
6	Melan	0.2					
7	Maqëllarë				0.5	4.2	0.6
8	Kastriot				0.25	4	0.5
	TOTAL	1.7	3.6	0.6	0.75	8.2	1.1

3.7 Të ardhurat nga bimët aromatike dhe mjekësore

Për të kuptuar të ardhurat që gjenerojnë vjelësit nga aktiviteti e mbledhjes dhe kultivimit të BMA-ve, na vjen në ndihmë tabela në vijim.

Tabela 17: Të ardhurat e vjelësve nga mbledhja dhe kultivimi i BMA-ve

Vjelesi Nr.	Njësia administrative	Te ardhurat ne leke nga BMA-te			Perqindja qe zene te ardhura nga BMA-te		
		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1	Muhurr	150,000	150,000	150,000	25%	25%	25%
2	Muhurr	100,000	100,000	150,000	25%	25%	25%
3	Melan	500,000	500,000	500,000	70%	70%	70%
4	Melan	160,000	200,000	250,000	30%	40%	50%
5	Melan	100,000	120,000	200,000	20%	25%	40%
6	Melan	200,000	180,000	250,000	35%	30%	40%

7	Melan	700,000	700,000	700,000	90%	90%	90%
8	Melan	500,000	500,000	500,000	80%	80%	80%
9	Melan	650,000	650,000	700,000	90%	90%	90%
10	Melan	650,000	650,000	700,000	90%	90%	90%
11	Melan	320,000	400,000	450,000	70%	75%	80%
12	Melan	100,000	150,000	130,000	25%	35%	30%
13	Melan	50,000	100,000	200,000	10%	20%	40%
14	Melan	100,000	150,000	250,000	20%	25%	30%
15	Melan	100,000	240,000	270,000	25%	40%	60%
16	Melan	100,000	230,000	250,000	25%	40%	60%
17	Maqëllarë	250,000	500,000	250,000	50%	100%	50%
18	Maqëllarë	300,000	350,000	350,000	40%	55%	55%
19	Maqëllarë	400,000	400,000	500,000	70%	70%	80%
20	Maqëllarë	200,000	400,000	400,000	30%	70%	70%
21	Kastriot	220,000	220,000	250,000	30%	30%	40%
22	Kastriot	950,000	600,000	850,000	100%	100%	100%
23	Kastriot	400,000	300,000	400,000	80%	70%	80%
24	Kastriot	300,000	300,000	220,000	50%	50%	45%
25	Kastriot	200,000	100,000	300,000	45%	25%	45%
26	Kastriot	100,000	100,000	100,000	25%	25%	25%
27	Kastriot	100,000	150,000	200,000	25%	30%	35%
28	Kastriot	100,000	120,000	160,000	25%	30%	35%
29	Kastriot	500,000	600,000	900,000	50%	60%	90%
30	Kastriot	500,000	300,000	100,000	100%	60%	25%
31	Kastriot	60,000	100,000	120,000	12%	25%	30%
32	Kastriot	200,000	200,000	200,000	40%	40%	40%
33	Kastriot	500,000	400,000	600,000	80%	70%	90%
34	Kastriot	100,000	80,000	100,000	25%	15%	25%
35	Sllovë	20,000	30,000	50,000	3%	6%	10%
36	Sllovë	70,000	50,000	80,000	15%	10%	15%
37	Sllovë	200,000	34,000	34,000	40%	7%	7%
38	Sllovë	340,000	340,000	340,000	60%	60%	60%
39	Sllovë	100,000	200,000	200,000	20%	40%	40%
40	Sllovë	100,000	100,000	100,000	20%	20%	20%
TOTAL		10,690,000	10,994,000	12,454,000			

Në vitin 2020, 40 vjelësit e intervistuar deklarojnë të kenë përfituar 10,690,000 lekë nga aktiviteti i grumbullimit të BMA-ve. Në 2021, të ardhurat kanë shkuar në 10,994,000 lekë dhe në 2022, totali i të ardhurave është 12,454,000 lekë. Mesatarisht për vitin 2022 një famije vjelësish ka gjeneruar 311,350 lekë.

Për të krijuar një ide të qartë se ç'përqindje zënë të ardhurat nga aktiviteti i mbledhjes së BMA-e kundrejt të ardhurave totale të familjes, i referohemi kolonës së dytë të tabelës. 23 vjelës pohojnë se këto të ardhura zënë 7% deri në 45% të të ardhurave totale të familjes. Kjo nënkupton se ata kanë burime të tjera të të ardhurave për të jetuar. 11 vjelës deklarojnë se të ardhurat nga BMA-të zënë një vend të konsiderueshëm në të ardhurat totale 50% - 80%. Së fundmi 6 vjelës pohojnë se të ardhurat nga BMA-të zënë 90% - 100% të të ardhurave totale të familjes, gje që nënkupton se kjo punë është mënyra bazë e jetesës së tyre.

3.8 Bashkëpunimi midis vjelësve dhe grumbulluesve, logjistika.

Nga intervistat e kryera, të gjithë vjelësit deklarojnë se bashkëpunojnë midis tyre për transportin e BMA-ve, dhe 13 prej tyre bashkëpunojnë për shitjen e BMA-ve.

Ndërkohë, për sa i përket logjistikës, ata nuk zotërojnë linja dhe pajisje për tharjen e bimëve aromatike dhe mjekësore. Të gjithë vjelësit pohojnë se i thajnë bimët aromatike dhe mjekësore pranë shtëpive të tyre: jashtë në diell, nën ndikimin potencial të ndotjes; në oborre dhe tarraca.

3.9 Të dhëna të përgjithshme për grumbulluesit dhe përpunuesit e BMA-ve

Në zonën e Dibrës janë identifikuar 3 grumbullues të vegjël me kapacitet 5 – 50 ton BMA të thata në vit dhe një përpunues. Dy prej tyre i përkasin grupmoshës 36 – 60 vjeç dhe dy të tjerë janë mbi 60 vjeç. Nuk është identifikuar ndonjë grua si grumbulluese dhe përpunuese. Megjithatë vlen për t'u theksuar fakti se këto janë biznese familjare ku gratë luajnë një rol të rëndësishëm në aktivitetin e grumbullimit dhe përpunimit të BMA-ve. Për sa i përket shpërndarjes gjeografike, 1 grumbullues është në qytetin e Peshkopisë, 1 grumbullues në Maqellarë, 1 grumbullues në Melan dhe përpunuesi është në qytetin e Peshkopisë.

Tabela 18: Grumbulluesit dhe përpunuesit e BMA-ve, Dibër

Grup bulluesi si Nr.	Bashkia	Njesia administra tive	Gjinia	Grup mosha 18 - 25	Grup mosha 26 - 35	Grup mosha 36 - 60	Grup mosha >60	Nr. i mbledh esve	Grup ferm eresh	Grumbull ues lokal (5 - 50 ton bime ne vit)	Procesu es i vogel (20 - 100 ton)
1	Diber	Peshkopi	M				x	280			x
2	Diber	Maqellare	M				x	70		x	
3	Diber	Melan	M			x		60		x	
4	Diber	Peshkopi	M			x		150		x	

Këta grumbullues dhe përpunues të BMA-ve pohojnë se bashkëpunojnë me 560 vjelës në total të zonës së mbrojtur Korab – Koritnik. Përpunuesi bashkëpunon me 280 vjelës, grumbulluesi i Peshkopisë me 150 vjelës, grumbulluesi i Maqëllarës me 70 vjelës dhe grumbulluesi i Melanit me 60 vjelës.

Sasitë e BMA-ve të deklaruara nga grumbulluesit dhe përpunuesit e intervistuar

Nga intervistat e zhvilluara, grumbulluesit dhe përpunuesit të BMA-ve të zonës së Dibrës pohojnë të kenë kenë grumbulluar rreth 241 ton BMA- të njoma ose rreth 65 ton BMA të thata në vitin 2022. Grumbulluesi i Maqëllarës ka mbledhur rreth 20 ton BMA të thata, grumbulluesi i Melanit 10.6 ton, grumbulluesi i Peshkopisë 10 ton dhe përpunuesi i Peshkopisë rreth 25.5 ton BMA të thata. Nga tabela kuptojmë se cilat janë bimët aromatike dhe mjekësore me peshë më të madhe në zonën Korab – Koritnik. Dëllinja e zezë është produkti kryesor me 15 ton produkt i thatë në vitin 2022. Gjethja e tharë e qershigllës zë gjithashtu vend të rëndësishëm me 7.5 ton. Më pas renditen produkte të tilla si qumështore me 6 ton, rrush ariu dhe shtogu kokërr me përkatësisht 4 ton. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur sasitë e grumbulluara të BMA-ve nga pikat e grumbullimit dhe përpunimit në Dibër.

Tabela 19: *Sasia e BMA-ve të grumbulluara nga grumbulluesit lokalë dhe përpunuesit e Dibrës*

Produkti	Grumbulluesi 1 – Maqellare		Grumbulluesi 2 - Melan		Grumbulluesi 3 – Peshkopi		Përpunuesi - Peshkopi		Total	
	Sasia e njome (ton)	Sasia e thate (ton)	Sasia e njome (ton)	Sasia e thate (ton)	Sasia e njome (ton)	Sasia e thate (ton)	Sasia e njome (ton)	Sasia e thate (ton)	Sasia e njome total (ton)	Sasia e thate total (ton)
Dellinjë e zezë			5	2	12	4	27	9	44	15
Qershigël (flete)	8	2					17	5.5	25	7.5
Qumështore	10	2	10	2			10	2	30	6
Rrush ariu	9	3					4	1	13	4
Shtog (kokerr)	7	2					6	2	13	4
Hither	12	2.4					4.2	1.4	16.2	3.8
Mollë e egër	3	1.2	1.5	0.6	2.5	1	2.5	1	9.5	3.8
Lëvore fasuleje			3.5	1	6	2			9.5	3
Qingël	5.6	1.4	5	1.5					10.6	2.9
Lule shtogu	9	1.5	4.8	0.8					13.8	2.3
Bisht kali	6.5	1.3			4.5	0.9			11	2.2
Dëllinjë e kuqe							6	2	6	2
Tërfil i kuq			5.4	0.9	4.0	0.8			9.4	1.7
Agulice			6	1	2.1	0.3			8.1	1.3
Qershigël (kokerr)	1.2	0.3			2	0.5			3.2	0.8
Balsam							1.8	0.6	1.8	0.6
Vodhe e eger			1.5	0.6					1.5	0.6
Rrënjë korolineje					2.5	0.5			2.5	0.5
Lulekuqe			1.6	0.2					1.6	0.2
Te tjera	12	3.0							12	3

TOTAL	83.3	20.1	44.3	10.6	35.6	10.0	78.5	24.5	241.7	65.2
-------	------	------	------	------	------	------	------	------	-------	------

3.10 Trajnimi me vjelësit e zonës së mbrojtur Korab Koritnik

Shoqata “Për një Zhvillim Rural të Qendrueshëm” organizoi në Dibër një trajnim me vjelësit e zonës së mbrojtur Korab Koritnik më dt 21.12.2022. me temë “Potencialet dhe menaxhimi i bimëve aromatike dhe mjekësore në KKPA”. Trajnimi kishte për qëllim rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të vjelësve të kësaj zone të mbrojtur, si dhe ndërgjegjësimin e tyre për një shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore të kësaj zone. Në trajnim morën pjesë 14 vjelës nga të cilët 8 ishin gra.

Për të bërë një vlerësim të drejtë të efektivitetit të trajnimit, pjesëmarrësit plotësuan një pyetësor vetëvlerësimi të njohurive të tyre. Pyetësi përbëhej nga 6 pyetje dhe pjesëmarrësit do të jepnin një vlerësim të shkallës së njohjes nga 1 deri 5.

Tabela 20: Vetëvlerësimi i njohurive të pjesëmarrësve para dhe pas zhvillimit të trajnimit

Pyetja	Rezultatet para trajnimit	Rezultatet pas trajnimit	Ndryshimi në saj të trajnimit
1. Unë kam njohuri për Bimet Mjekësore dhe Aromatike (BMA), trendin e grumbullimit dhe të ardhurave për vitet e fundit, potencialet e tyre në nivel kombëtar, situatën e kultivimeve të BMA në vend dhe sfidat e BMA-ve për të ardhmen.	2.1	4.0	1.9
2. Unë i njoh BMA në Zonën e Mbrojtur Korab-Koritnik (KKPA), bimët e florës spontane që mblidhen në zonën e mbrojtur Korab – Koritnik (produktet tipike, produktet e zonës, statusin e BMA të Korab-Koritnik në Librin e Kuq të Shqipërisë).	1.9	4.0	2.1
3. Unë di praktika e mira në vjeljen dhe pasvjeljen e BMA të florës spontane dhe praktika e mira bujqësore të BMA të kultivuara me ndikim në erozionin gjenik, ruajtjen e qëndrueshme të biodiversitetit dhe menaxhimin e BMA-ve.	1.9	4.1	2.2
4. Unë di të vlerësoj potencialet e vjelësve për çdo njësi administrative pranë Zonës e Mbrojtur Korab-Koritnik (KKPA), situata në BMA të kultivuara pranë Zonës e Mbrojtur Korab-Koritnik (KKPA) dhe trendin dhe mundësitë e shfrytëzimit të diversitetit të BMA për të ardhmen.	1.5	3.9	2.4

5. Une di të vlerësoj potencialet e BMA-ve në zonën e parkut natyror, biodiversitetin e tyre dhe përfitimet ekonomike që rrjedhin nga aktivitetet kultivuese/grumbulluese të BMA-ve në KKPA.	2.0	3.9	1.9
6. Une di sasi të që grumbullohen nga grumbulluesit lokalë dhe përpunuesit në rrethin e Dibrës, kalendarin e vjeljeve për cdo specie dhe të ardhurat në vitet e fundit.	1.4	3.8	2.4
Mesatarja	1.8	4	2.2

Pyetjes së parë lidhur me njohuritë për BMA-të, trendin e grumbullimit dhe të ardhurat, potencialet në nivel kombëtar, situatën e kultivimeve të BMA-ve dhe sfidat për të ardhmen, pjesëmarrësit në trajnim dhanë një vlerësim mesatar prej 2.1 pikësh. Pas kryerjes së trajnimit, pjesëmarrësit dhanë një vlerësim prej 4 pikësh, që nënkupton një përmirësim të njohurive me 1.9 pikë.

Pyetja e dytë, që lidhej me shkallën e njohurive të pjesëmarrësve lidhur me BMA-të e florës spontane të zonës Korab Koritnik dhe statusin e tyre në Librin e Kuq të Florës së Shqipërisë, u vlerësua fillimisht nga pjesëmarrësit me 1.9 pikë. Pas trajnimit, kjo pyetje u vlerësua me një mesatare prej 4 pikësh, duke pasur një përmirësim prej 2.1 pikësh.

Pyetja e tretë lidhur me praktikën e mira të vjeljes dhe pasvjeljes të BMA-ve të florës spontane dhe atyre të kultivuara, pati një vlerësim prej 1.9 pikësh para trajnimit. Pas zhvillimit të trajnimit, kjo pyetje u vlerësua me një mesatare prej 4.1 pikësh ose 2.2 pikë më shumë se vlerësimi fillestar.

Pyetja e katërt që lidhej me potencialet e vjelësve të zonës së mbrojtur Korab – Koritnik, situatën e BMA-ve të kultivuara në këtë zonë, si dhe trendin dhe shfrytëzimin e diversitetit në të ardhmen, u vlerësua shumë ulët në fillim të trajnimit me vetëm 1.5 pikë. Pas trajnimit, pjesëmarrësit vlerësuan se njohuritë e tyre për këtë çështje u përmirësuan në nivelin e 3.9 pikëve, me një ndryshim prej 2.4 pikësh.

Pyetja e pestë, që kishte të bënte me potencialet e BMA-ve në parkun natyror dhe përfitimet ekonomike nga aktivitetet e grumbullimit dhe kultivimit, u vlerësua me 2 pikë para trajnimit dhe me 3.9 pikë pas trajnimit. Përmirësimi i njohurive për këtë çështje ishte në nivelin e 1.9 pikëve.

Së fundmi, pyetja e gjashtë, lidhur me njohuritë për sasi të BMA-ve që grumbullohen në zonën e mbrojtur dhe kalendarin e vjeljes së tyre u vlerësua fillimisht me 1.4 pikë. Pas trajnimit, njohuritë për këtë çështje u vlerësuan me 3.8 pikë ose 2.4 pikë më shumë.

Mesatarja e vlerësimit të njohurive pati një rritje të konsiderueshme në saj të trajnimit të kryer. Nga 1.8 pikë që u vlerësua fillimisht nga pjesëmarrësit në trajnim, arriti në nivelin e 4 pikëve, ose 2.2 pikë më shumë.

Shoqata “Për një Zhvillim Rural të Qendrueshëm” vlerëson së trajnimi i zhvilluar me vjelësit e BMA-ve të zonës së mbrojtur Korab – Koritnik ishte i suksesshëm dhe pati një impakt të ndjeshëm në rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin e tyre.

4.Perfundimet/Konkluzionet

- Zona Korab-Koritnik është Rezervat Natyror i Menaxhuar (RNM)/Park Natyror (PN), Kategoria IV-t (IUCN), me sipërfaqje 55,550.2ha (555.5 km²)., miratuar me VKM nr.898, datë 21.12.2011.
- Brenda parkut natyror Korab-Koritnik zona e kullotave dhe livadheve zë një sipërfaqe prej 22,578.4 ha, pyjet mbulojnë 19,264 ha, toka bujqësore 8,670.9 ha, zonat malore shkëmbore dhe tokat e gërryera 4,530.8 ha, zonat urbane 385.6 ha dhe sipërfaqet ujore 385.6 ha.
- Në zonën e mbrojtur Korab – Koritnik popullsia jeton me të ardhura të ulëta dhe janë të rrezikuar nga papunësia.
- Në rezervatin natyror Korab – Koritnik janë të evidentuara rreth 511 lloje të ndryshme bimësh fanerogame, nga të cilat, 316 specie nga 52 familje janë të klasifikuara si bimë mjekësore dhe aromatike ose rreth 61.8% të florës së zonës së mbrojtur Korab Koritnik
- 32 lloje të florsë vaskulare janë të përfshira në Librin e Kuq të Florës së Shqipërisë, klasifikuar si në rrezik zhdukjeje në shkallë të ndryshme: 3 bimë në status “kritik” (CR), 12 bimë në statusin “në rrezik” (EN), 10 bimë në statusin “vulnerabël” (VU), dhe 7 bimë në statusin “në rrezikim më të ulët”.
- Para vitete '90, në zonën e mbrojtur Korab – Koritnik grumbulloheshin dhe eksportoreshin 91 bimë mjekësore dhe aromatike, në një sasi prej 5,374 ton në një vlerë rreth 1.1 milion \$.
- Aktualisht, mbledhen dhe eksportohen 63 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike në këtë zonë, nga të cilat 16 prej tyre janë të klasifikuara në një nga statuset e rrezikimit.
- U zhvilluan intervista me 40 vjelës nga 5 njësi administrative të zonës së Mbrojtur Korab – Koritnik: Muhurr, Melan, Maqëllarë, Kastriot dhe Sillovë.
- Vjelësit i përkasin grupmoshës 36 – 60 vjeç me një përfaqësim prej 60%

- Mesatarisht një familje vjelësish rezulton të gumbullojë, thajë dhe shesë rreth 854.5 kg BMA të thata në vit që gjenerojnë mesatarisht rreth 311,350 lekë në vit.
- Bimët kryesore që grumbullohen në florën spontane të zonës së mbrojtur Korab – Koritnik janë: qershigla (boronica), qumështorja, dëllinja e zezë, shtogu, tërfili i kuq, balsami, aguliçja, etj. Kultivimi i BMA-ve në zonën e parkut kombëtar Korab – Koritnik është në fillesat e tij
- Bimët kryesore të kultivuara janë tërfili i kuq dhe ciani, që mbillen në sipërfaqe 0.2 – 0.4 ha
- Vjelësit nuk zotërojnë linja për tharjen e BMA-ve; ata e kryejnë tharjen në mënyrë natyrale pranë ambjenteve të shtëpisë.
- Lind nevoja për trajnimin e vjelësve për menaxhimin e qëndrueshëm të florës spontane të zonës së mbrojtur Korab – Koritnik
- Është i domosdoshëm organizimi i tharjes së përbashkët të bimëve të grumbulluara nga vjelësit, në pajisje për tharjen artificiale (tunele diellore), për të rritur cilësinë e bimëve të thara ; për të minimizuar ndotjen dhe humbjen gjatë tharjes natyrale në diell; duke rritur të ardhurat e vjelësve.
- Zonat rurale pranë zonës së mbrojtur të parkut natyror Korab – Koritnik kanë potenciale të mëdha për kultivimin e bimëve aromatike dhe mjekësore, të cilat mund të shfrytëzohen më mirë nga banorët e këtyre zonave.

5. Referencat

Program. Databaza tregtare e EUROSTAT (2018,2019): <http://ec.europa.eu/eurostat/en/data/database>.

FAO (2013): Agrifood chain organization in Albania – the case of MAPs and fruits.

Forest Genetic Resources Working Papers State of Forest Tree Genetic Resources in Albania by Maxhun Dida General Directorate for Forestry and Pasture Tirana 2003

Ibraliu A. (2018). Vlerësimi i Resurseve Gjenetike të Bimëve në Shqipëri. UNDP-GEF “Forcimi i burimeve njerëzore, kuadrit ligjor dhe kapaciteteve institucionale për zbatimin e Protokollit të Nagojës” (Projekti global për ABS).

Ibraliu A, Faslia N, Mullaj A dhe X Mi (2014): Status of Medicinal Plant Research in Albania. 2014. Current Trends in Medicinal Botany. I.K. International Publishing House Pvt. Ltd. ISSN 978-93-82332-50-3, f. 61-76.

Ibraliu A, Mullaj F, Elezi J, Shehu dhe Gixhari B (2014): Burimet gjenetike të bimëve medicinale dhe aromatike të Shqipërisë - Statusi aktual i koleksionit kombëtar të BMA-ve në Shqipëri. Diskutimet e CMAPSEEC TË 8-të, Durrës, Shqipëri

KEÇI Erjola, Elisabeth KROG - 15/12/2014 “Mountains Natural Ecosystem “Korab - Koritnik Natural Park” Management Plan”

Hyko E, Miho A. – September 2018 “Veshtrim mbi bimët aromatike – mjekësore të Qarkut Diber, Shqipëri / Overview of medicinal and aromatic plants in Dibra region

Paparisto K, Demiri M, Mitrusha I, Qosja Xh (1988): Flora e Shqipërisë. Vëll. 1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri.

Lista e kuqe e florës dhe faunës së egër (2013), Shqipëri, miratuar me urdhër të ministrit nr. 1280, datë 20.11.2013

Gjoni Z.(2018) Vjelja dhe grumbullimi i bimëve mjekësore të Dibrës. SNV Diber

Vangjeli J, Ruci B, Mullaj A. (1995): Libri i Kuq (bimët e kërcënuara dhe të rralla të Shqipërisë). Instituti i Kërkimeve Biologjike, Akademia e Shkencave, Tiranë, Shqipëri

6. Anekset

Aneks 1.1. Lista e plotë e bimëve në parkun kombëtar Korab Koritnik

Aneks 1.2. Lista e bimëve mjekësore dhe aromatike në parkun kombëtar Korab Koritnik

Aneks 1.3 Lista e bimëve mjekësore dhe aromatike në parkun kombëtar Korab Koritnik në rrezik

Aneks 1.4 BMA-të e grumbulluara në vitin 1988 dhe sot

Aneks 2.1. Të dhëna të përgjithshme të vjelësve të intervistuar

Aneks 2.2 Vjelësit sipas grupmoshës

Aneks 2.3 Bimët e florës spontane 2022 të deklaruar nga vjelësit e intervistuar

Aneks 2.4 Sasia e BMA-ve të deklaruar nga vjelësit e intervistuar

Aneks 2.5 Numri i vjelësve për cdo bimë

Aneks 2.6. BMA-të e kultivuara në zonën Korab Koritnik

Aneks 2.7 Të ardhurat nga vjelja e bimëve mjekësore të deklaruar nga vjelësit e intervistuar

Aneks 2.8. Bashkëpunimi i vjelësve të intervistuar dhe logjistika për tharjen / ruajtjen e produkteve

Aneks 3.1: Të dhëna të përgjithshme të grumbulluesve të zonës Korab Koritnik

Aneks 3.2: Sasi të BMA-ve të florës spontane të grumbulluara në parkun kombëtar Korab Koritnik

Aneks 3.3: Sasi të BMA-ve të kultivuara të deklaruar nga grumbulluesit

Aneks 3.4. Kalendari i vjeljeve të BMA-ve në zonën Korab Koritnik

Aneks 3.5. Nevoja për logjistike të grumbulluesve